

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.5/6, Maj - Qershor 2023

IMZOT GALLAGHER: DIPLOMACIA E VATIKANIT, VEPËR E BARINJVE TË KISHËS, JO E FUNKSIONARËVE

Në konferencën e promovuar nga shoqata “Bamirësia Politike”, Sekretari për Marrëdhëniet me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare theksoi vlerën e kulturës së takimit në punën e përfaqësuesve të Vatikanit në mbarë botën: për ta promovuar atë, ata duhet të jenë njerëz të palodhur të paqes.



“Të zhvillojmë “kulturën e takimit”, pasi vetë diplomacia bart në vetvete përpjekjen për takim”: mbi këtë nevojë themelore u mbajt më 19 qershor, në Romë, konferenca e organizuar nga shoqata e së drejtës papnore “Bamirësia Politike”. Vërtet, diplomacia është “mjet dialogu, bashkëpunimi dhe pajtimi” e jo pretendime e kundërvënje vëllavrasëse; është në gjendje ta zëvendësojë përdorimin e forcës, siç thuhet në një notë të shoqatës. Konferenca “Diplomacia e Selisë së Shenjtë dhe kultura e takimit” u koordinua nga Alfredo Luciani, president i “Bamirësisë Politike”, me pjesëmarrjen e imzot Paul Richard Gallagher, Sekretar i Vatikanit për Marrëdhëniet me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare, të Mahmoud Talaat, ambasador i Republikës Arabe të Egjiptit në Selinë e Shenjtë dhe të Marcus Bergmann, ambasador i Austrisë në Selinë e Shenjtë.

Kultura e takimit, baza e thirrjes misionare të përfaqësuesve papnorë

“Kultura e takimit - pohoi imzot Gallagher - qëndron në themel të thirrjes misionare që përjetojnë përfaqësuesit papnorë, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre, gjatë shërbimit në vende të ndryshme të botës”. Në fjalën e tij, kryepeshkvi vuri në dukje disa episode biblike, bazë për reflektimin mbi diplomacinë papnore: nga takimi ndërmjet Abrahamit dhe priftit Melkizedek (Zan 14,17-20) - shembull i qartë i miqësisë ndërmjet popujve, që në kohëra të lashta - në atë të Elizeut profet me Naamanin, kreun e ushtrisë së mbretit të Aramit (2 Mbret 5) e deri në takimin ndërmjet Darit, mbretit të persianëve, dhe Danielit profet, i cili u hodh në mes të luanëve për shkeljen e dekretit, që ndalonte lutjet për çdo lloj hyjni, përveçse për

vetë monarkun (Dan, 6). Në Ungjij rrëfohen disa takime me të huajt, të cilët kanë Jezusin si protagonist: shërimi i shërbëtorit të centurionit romak (Mt 8,5-13) dhe i vajzës së një gruaje sirofenikase në rajonin e Tirit e të Sidonit (Mk 7,24-30), shëmbëlltyra e Samaritanit të Mirë (Lk 10,25-37), biseda me gruan samaritane, pranë pusit (Gjn 4,1-42) dhe dialogu me Poncin Pilat (Gjn 18,33-40).

Diplomatët e Selisë së Shenjtë nuk janë zyrtarë, por barinj të Kishës

Takimet e Jezusit kanë gjithmonë karakter personal, nënvizoi imzot Gallagher, e kështu duhet të jetë edhe për takimet e diplomatëve të Selisë së Shenjtë, të cilët “nuk janë zyrtarë, por barinj të Kishës, prandaj u flasin zemrave të njerëzve, që presin në audiencë, si kryepeshkvij dhe meshtarë”. Libri biblik, që shpreh më së miri kulturën e takimit, është ai i Veprave të Apostujve, ku gjejmë historinë e Rrëshajëve, “mbi të cilën bazohet siguria e krishterë se qeniet njerëzore mund ta kuptojnë njëra-tjetrën dhe të jetojnë të bashkuar” në marrëdhënie vëllazërore e solidarë. Kulturën e takimit e gjejmë edhe në shkrimet e Shën Palit apostull e në Librin e Zbulesës, i cili rrëfen takimin e fundit të njerëzimit me hyjnorin, që na kujton rëndësinë e dëshmisë. “Vërtet, për të promovuar kulturën e takimit, diplomati i Selisë së Shenjtë duhet të jetë dëshmitar autentik i Ungjillit, veprimtar i palodhur i paqes dhe apostull i apasionuar i pajtimit”.

Poli i Feve në Romë

Për shoqatën “Bamirësia Politike”, konferenca ishte rast për të paraqitur themelimin e Polit të Feve në Romë, në përgatitje të Jubileut të ardhshëm. Në zanafillën e kësaj nisme qëndron, në radhë të parë, vetëdija për rëndësinë e dialogut ndërmjet kulturave dhe feve, por edhe prania në rritje e anëtarëve të feve të mëdha botërore në Romë, qytet, që duhet të jetë pikë referimi për kulturën e takimit. Poli i Feve ka një qëllim të përbashkët me diplomacinë: t'i shndërrojë fetë nga burime konflikti në mjete të paqes, të solidaritetit e të vëllazërimit njerëzor.



Papa Françesku TË ECIM DHE TË SHKOJMË PËRPARA NË JETË!	4
Papa Françesku KULTURA DUKE U ZHYTUR NË BRAZDA TE REALITETIT, JEP FRYTE	8
Dom Ernest Simoni KUR PËR PASHKË NUK BININ KËMBANAT	11
Imzot Angelo Massafra OFM DIKTATURA SHKATËRRON NDËRGJEGJET E NJERËZVE	13
Imzot Angelo Massafra OFM NË MARINË, KISHA E BASHKUAR TE KËMBËT E KRYQIT	15
Imzot Angelo Massafra OFM FTESA E MARISË PËR TË BËRË ATË QË JEZUSI NA THOTË TË BËJMË!	16
Motër Dila Shtjefni PSE NJË MUAJ MARIAN DHE CILA ËSHTË FIZIONOMIA E KËSAJ PËRSHPIRTËRIE?	21
Moter Marjeta Gjoka ZEMRA E JEZUSIT E DHURUAR PËR NJERËZIMIN	22
Dom Lush GJERGJI PAPA GJONI XXIII DHE KONCILI I DYTË I VATIKANIT	25
Violeta Marashi NË KËTË TEMPULL HYJI VENDOS BANESËN E TIJ	30
Redaksia STATUTET E SHKODRËS TË RRETH 700 VITEVE MË PARË	31
Redaksia VITRINË LIBRI	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVI, nr. 5/6 (567 - 568) Maj - Qershor 2023

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



PAPA TË RINJVE : TË ECIM DHE TË SHKOJMË PËRPARA NË JETË!

*Fjala e Atit të Shenjtë “Papp László Budapest Sportaréna” (Budapest)
E shtunë, më 29 prill 2023*

*Udhëtimi apostolik i shenjtërisë së tij Françeskut në Hungari
(28 - 30 prill 2023)*

Dicsértessék a Jézus Krisztus! [Qoftë lëvdur Jezu Krishti!]

Të dashur vëllezër dhe motra, dua t'ju them *köszönöm!* [Faleminderit!]. Faleminderit për kërcimin, faleminderit për këngën, faleminderit për dëshmitë tuaja të guximshme dhe faleminderit të gjithëve që jeni këtu: Jam i lumtur që jam me ju! Faleminderit.

Ipeshkvi Ferenc na tha se rinia është koha e pyetjeve të mëdha dhe e përgjigjeve po të mëdha. Është e vërtetë, dhe është e rëndësishme, që është dikush që provokon dhe dëgjon pyetjet tuaja, duke mos dhënë përgjigje të lehta, përgjigje të gatshme, por duke ju ndihmuar që ta sfidoni pa frikë aventurën e jetës në kërkim të përgjigjeve të mëdha. Përgjigjet e gatshme nuk i duhen askujt, nuk të bëjnë të lumtur. Në fakt, kështu bënte Jezusi. Bertalan, ti the se Jezusi nuk është një personazh i një libri përrallash apo superheroi i një filmi vizatimor, dhe kjo është e vërtetë; Krishti është Hyj, është Hyji i gjallë që na afrohet; është Miku, miku më i mirë, është Vëllai, vëllai më i mirë dhe është shumë i zoti për të bërë pyetje. Në të vërtetë, në Ungjill, Ai, që është Mësuesi, përpara se të japë

përgjigje bën pyetje. Mendoj për momentin kur Ai gjendet përballë gruas kurorëshkelëse drejt të cilës të gjithë po e drejtonin gishtin. Jezusi ndërhyr, ata që e akuzonin largohen dhe Ai mbetet vetëm me të. Pastaj me delikatesë e pyet: “*Grua ku janë ata? Askush nuk të dënoi?*” (Gjn 8,10). Ajo përgjigjet: “*Askush, Zotëri!*” (rr. 11). Dhe kështu, ndërsa e thotë, kupton se Hyji nuk dëshiron ta dënojë, por ta falë atë. Nguleni mirë në kokë këtë gjë: Hyji nuk dëshiron të dënojë, por të falë. *Zoti fal gjithmonë*. Si thuhet “*Zoti fal gjithmonë*” në hungarisht? [përkthyesi e thotë në hungarisht dhe Papa u kërkon të rinjve që ta përsërisin]. Mos e harroni kurrë këtë gjë! Ai është gati të na ngrejë sa herë që ne rrëzohemi! Prandaj, me Të nuk duhet të kemi kurrë frikë të ecim dhe të shkojmë përpara në jetë. Të mendojmë edhe për Mari Magdalenën, e cila në mëngjesin e Pashkës ishte e para që pa Jezusin e ringjallur - dhe ajo grua kishte një histori!, por ishte e para që e pa atë. Ajo ishte e përplotur pranë varrit të zbrazët dhe Jezusi e pyet: “*Pse po qan, moj fisnike? Kë po kërkon?*” (Gjn 20,15). Dhe kështu Maria e Magdalës hap zemrën e saj, i tregon atij për ankthet e saj, i zbulon dëshirat dhe dashurinë e saj: “*Zotëri, nëse e ke marrë ti, më trego ku e vure e tash po e marr unë*”.





Të shohim takimin e parë të Jezusit me ata që do të bëheshin nxënësit e tij. Dy prej tyre, të drejtuar nga Gjon Pagëzuesi, shkojnë pas Tij. Zoti kthehet dhe u bën vetëm një pyetje: “Çka kërkon?” (Gjn 1,38). Edhe unë po ju bëj një pyetje dhe secili të përgjigjet në zemrën e vet, në heshtje. Pyetja ime është: “Çfarë po kërkon? Çfarë kërkon në jetë? Çfarë kërkon në zemrën tënde?”. Në heshtje, secili të përgjigjet brenda vetes. Çfarë kërkoj unë? Jezusi nuk predikon shumë, jo, ai ecën, ecën së bashku me secilin prej nesh; Jezusi ecën pranë secilit prej nesh. Nuk do që nxënësit e Tij të jenë nxënës shkolle që përsërisin një mësim, por të jenë të rinj të lirë dhe që ecin, shokë rruge të një Hyji që dëgjon, që dëgjon nevojat e tyre dhe është i vëmendshëm ndaj ëndrrave të tyre. Pastaj, pas shumë kohësh, dy nxënësit e rinj rrëshqasin keq - nxënësit e Jezusit kanë rrëshqitur shumë! – dhe i bëjnë një kërkesë të gabuar Jezusit: të qëndrojnë në të djathtën dhe në të majtën e Tij kur të bëhet Mbret – donin të kacavirreshin, këta! Por është interesante të shohim se Jezusi nuk i qorton se kanë guxuar, nuk u thotë: “Si guxoni, boll ëndërruat me sy hapur!”. Jo, Jezusi nuk ua prish ëndrrat, por i korrigjon se si t’i realizojnë ato; Ai pranon dëshirën e tyre për të arritur majat – kjo është diçka e mirë – por këmbëngul në një gjë, që duhet mbajtur mend mirë: njeriu nuk bëhet i madh duke shkelur mbi të tjerët, por duke u ulur nën të tjerët; jo në kurriz të të tjerëve, por duke u shërbyer atyre (krh. Mk 10,35-45). [i kërkon përkthyesit të përsërisë fjalinë e fundit në hungarisht] A e keni kuptuar? Shikoni miq, Jezusi është i lumtur kur arrijmë qëllime të mëdha, nuk do që të jemi dembelë dhe përtacë, nuk do që të heshtim dhe të jemi të ndrojtur, na do të gjallë, aktivë, protagonistë, protagonistë të historisë. Dhe nuk i zhvlerëson kurrë pritshmëritë tona, por përkundrazi, ngre shkopin/drushkën e dëshirave tona. Jezusi do të pajtohej me fjalën tuaj të urtë, të cilën shpresoj ta shqiptoj mirë: *Akimeraznyer* [Fiton ai që guxon].

Ju mund të më pyesni: si mund të jemi fitimtarë në jetë? Ka dy kalime themelore, si në sport: së pari, syno lart; së dyti, stërvitu. *Syno lart*. Më thuaj, a ke një talent? Me siguri e ke, të gjithë e kemi! Mos e vër mënjandë duke menduar se për të qenë të lumtur mjafton minimumi i domosdoshëm: një diplomë, një punë për të fituar para, për t’u argëtuar... Jo, fute në punë atë që ke! A ke një cilësi të mirë? Investo mbi të, pa frikë, vazhdo! A e ndjen në zemër se ke një aftësi që mund të jetë e mirë për shumë njerëz? A e ndjen se është mirë ta duash Zotin, të krijosh një familje të madhe, t’i ndihmosh njerëzit në nevojë?

Vazhdo, mos mendo se janë dëshira të parealizueshme, por investo në qëllimet e mëdha të jetës! Ky është i pari, syno lart. Dhe i dyti: *stërvitu*. Po si? Në dialog me Jezusin, i cili është trajneri më i mirë i mundshëm. Ai të dëgjon, Ai të motivon, Ai beson në ty, a e di?, Jezusi beson te ti!, Ai di të nxjerrë më të mirën tënde. Dhe gjithmonë na fton që të jemi një skuadër: asnjëherë vetëm, por me të tjerët: kjo është shumë e rëndësishme. Nëse ti dëshiron të piqesh dhe të rritesh në jetë, bëj skuadër në bashkësi, duke jetuar përvoja të përbashkëta. Mendoj, për shembull, për Ditët Botërore të Rinisë dhe përfitoj nga rasti t’ju ftoj në atë të radhës, që do të jetë në Lisbonë (Portugali), në fillim të gushtit. Sot, përkundrazi, ekziston tundimi i madh për t’u kënaqur me një celular dhe me ndonjë mik – është krejt pak, ju lutem! Por, edhe nëse kjo është diçka që bëjnë shumë vetë, edhe nëse është diçka që të pëlqen të bësh, nuk është diçka e mirë për ty. Nuk mund të mbyllesh në një grup të vogël miqsh dhe të flasësh vetëm me celularin: kjo është - më lejoni - diçka budallaqe.

Pastaj është një element i rëndësishëm për t’u stërvitur dhe këtë na e kujtove ti Krisztina duke thënë se mes një mijë garash, shumë furie dhe shpejtësie, ka një gjë thelbësore që sot u mungon të rinjve, por edhe të rriturve. The: “Nuk i lëmë vetes kohë për heshtje në zhurmë, sepse kemi frikë nga vetmia dhe pastaj çdo ditë përfundojmë të lodhur”. E the ti, Krisztina: faleminderit. Do të doja t’ju them: për këtë gjë mos kini frikë të shkoni kundër rrymës, të gjeni një kohë heshtjeje çdo ditë për t’u ndalur dhe për t’u lutur. Sot gjithçka ju thotë se duhet të jeni të shpejtë, efikasë, praktikisht të përsosur, si makinat! Por, të dashur, ne nuk jemi makina! Dhe pastaj kuptojmë se shpesh na mbaron benzina dhe nuk dimë çfarë të bëjmë. Na bën mirë të dimë të ndalojmë për t’u mbushur plot, për të rikarikuar bateritë. Por kujdes: jo për t’u zhytur në melankolinë apo për të ripërtypur trishtimin tonë, jo për të menduar atë që na ka bërë këtë apo atë, duke bërë teori se si sillen të tjerët; jo, kjo nuk është diçka e mirë! Ky është helm, kjo nuk bëhet.

Heshtja është toka mbi të cilën kultivojmë marrëdhënie të dobishme, sepse na lejon t’i besojmë Jezusit atë që jetojmë, t’i paraqesim fytyra dhe emra, të hedhim mbi Të shqetësimet tona, t’i shqyrtojmë miqtë tanë dhe të bëjmë një lutje për ta. Heshtja na jep mundësinë të lexojmë një faqe të Ungjillit që flet për jetën tonë, ta adhurojmë Zotin duke gjetur kështu paqen në zemrat tona. Heshtja të lejon të marrësh një libër që nuk je i detyruar ta lexosh, por që të ndihmon të lexosh shpirtin e



njeriut, të vëzhgosh natyrën për të mos qëndruar në kontakt vetëm me gjërat e bëra nga njerëzit dhe të zbulosh bukurinë që na rrethon. Por heshtja nuk është për t'u ngjitur pas celularëve dhe rrjeteve sociale; jo, ju lutem: jeta është reale, jo virtuale, nuk ndodh në një ekran, jeta ndodh në botë! Ju lutem, mos e virtualizoni jetën! E përsëris: mos e virtualizoni jetën, që është konkrete. A e kuptuat?

Prandaj, heshtja është dera e lutjes dhe lutja është dera e dashurisë. Dóra, do të doja të të falënderoja sepse fole për fenë si për një histori dashurie - kjo është diçka e bukur, është përvoja jote - ku çdo ditë përballesh me vështirësitë e adoleshencës, por ti e di që është Dikush me ty, Dikush për ty dhe se Ai Dikush, Jezusi, nuk ka frikë të kapërcejë me ty çdo pengesë që ti has. Lutja

e bukur. Dhe kur luteni, mos kini frikë t'ia paraqisni Jezusit gjithçka që kalon në botën tuaj të brendshme: dashuri, frikë, probleme, pritshmëri, kujtime, shpresa, gjithçka, edhe mëkate. Ai kupton gjithçka. Lutja është dialog jete, lutja është jetë. Bertalan, sot nuk ke pasur turp t'u tregojë të gjithëve për ankthin që të paralizon ndonjëherë dhe për vështirësinë për të besuar. Sa bukur është kur ke *guximin të jesh i vërtetë*, që nuk është të tregosh se nuk ke kurrë frikë, por të hapesh dhe t'i bashkëndash dobësitë e tua me Zotin dhe me të tjerët, pa u fshehur dhe pa u maskuar. Faleminderit për dëshminë tënde, Bertalan, faleminderit! Zoti, siç rrëfen Ungjilli në çdo faqe të tij, nuk bën gjëra të mëdha me njerëz të jashtëzakonshëm, por me njerëz të vërtetë, të kufizuar si ne. Përkundrazi, ata që mbështeten në aftësitë e tyre dhe jetojnë me



ndihmon për ta bërë këtë, sepse është dialog me Jezusin, ashtu si Mesha është takim me Të dhe Rrëfimi është përfaqimi që merr prej Tij. Më vjen në mendje muzikanti juaj i madh Ferenc Liszt. Gjatë pastrimit të pianos së tij u gjetën disa rruaza rruzareje të cilat ndoshta, gjatë këputjes, kanë rënë brenda instrumentit. Është një tregues që na bën të mendojmë se si, përpara një kompozimi ose një shfaqjeje, ndoshta edhe pas një momenti argëtimi në piano, e kishte zakon të lutej: i fliste Zotit, i fliste Zojës për atë që donte dhe e vinte artin dhe talentin e tij në lutje. Të lutesh nuk është diçka e mërzitshme! Jemi ne që e bëjmë të mërzitshme atë. Të lutesh është një takim, një takim me Zotin: kjo është diçka

pamjen e jashtme për t'u dukur në rregull, e mbajnë Zotin larg zemrës, sepse kujdesen vetëm për veten e tyre. Jezusi me pyetjet e Veta, me dashurinë e Vet, me Shpirtin e Vet, gërmon në ne për të na bërë njerëz të vërtetë. Dhe sot ka kaq shumë nevojë për njerëz të vërtetë! Po ju them diçka: a e dini se cili është rreziku sot? Të jesh një person i rremë. Ju lutem, kurrë një person i rremë, gjithmonë një person i vërtetë, me të vërtetën tënde! "Eh, Atë, mua më vjen turp, sepse realiteti im nuk është i mirë, e di, Atë, brenda kam disa gjëra...". Shiko përpara, te Zoti, ki guxim! Zoti na do ashtu siç jemi, si jemi tani, na do fort kështu. Guxim dhe përpara! Mos u trembni nga mjerimet tuaja.



Dhe në këtë drejtim, na ka prekur ajo që thatë ju, Tódor, duke filluar nga emri yt, të cilin e mban për nder të të Lumit Teodor, një dëshmitar i madh feje, i cili na kujton që të mos jemi oportunistë. Ke dashur “të vësh zilen”, duke thënë se zelli për misionin është anestezuar nga të jetuarit tanë në siguri dhe në rehati, ndërsa jo shumë kilometra nga këtu, lufta dhe vuajtjet janë në rend të ditës. Kjo është ftesa: ta marrim jetën tonë në dorë për ta ndihmuar botën që të jetojë në paqe. Ta lëmë veten të shqetësohemi prej kësaj, ta pyesim veten, secili prej nesh ta pyesë veten: çfarë bëj për të tjerët, çfarë bëj për shoqërinë, çfarë bëj për Kishën, çfarë bëj për armiqët e mi? A jetoj duke menduar për të mirën time apo përfshihem, pa llogaritur interesat e mia? Ju lutem, ta pyesim veten për falasshmërinë tonë, për aftësinë tonë për të dashur, *për të dashur sipas Jezusit*, domethënë për të dashur dhe për të shërbyer.

Të dashur miq, ka edhe një gjë të fundit që do të doja të bashkëndaja me ju, një faqe të Ungjillit që përmbledh atë që kemi thënë. Një vit e gjysmë më parë isha këtu për Kongresin Eukaristik; në Ungjillin e Gjonit, në kapitullin 6, ka një faqe të bukur eukaristike, e cila ka në qendër një të ri. Tregon për një djalë që ishte në turmë duke dëgjuar Jezusin. Ndoshta e dinte se takimi do të zgjaste shumë dhe kishte qenë largpamës: kishte sjellë drekën me vete - po ju, a keni marrë me vete një sanduiç? Por Jezusi ndjen dhembshuri për turmën - ishin më shumë se 5.000 vetë - dhe dëshiron ta ushqejë atë; atëherë, sipat stilit të vet, i pyet nxënësit për të zhbllokuar energjitë e tyre. Pyet njërin prej tyre se si mund t'ia bëjnë dhe i vjen një përgjigje “llogaritari”: *“As dyqind denarë bukë - iu përgjigj Filipi - nuk do të dilnin për t'i dhënë secilit nga një grimë”* (Gjn 6,7). Me fjalë të tjera: matematikisht e pamundur. Ndërkohë, një tjetër e sheh atë djalë dhe bën një vëzhgim, por edhe një herë pesimist: *“Këtu është një djalosh që ka pesë bukë elbi dhe dy peshq të vegjël. Por, çka janë këto për kaq njerëz?”* (rr. 9). Përkundrazi, Jezusit ato pesë bukë dhe dy peshq i dalin dhe i teprojnë për të kryer mrekullinë e famshme të shumëzimit të bukëve. Secili prej nesh,

gjërat e vogla që kemi, madje edhe mëkatet tona, i dalin Jezusit. Po ne, çfarë duhet të bëjmë? T'i lëmë në duart e Jezusit: kjo mjafton.

Por Ungjilli nuk tregon një detaj, të cilin ia lë në dorë imagjinatës sonë: si arritën nxënësit që ta bindin atë djalë që t'u jepte gjithçka që kishte? Ndoshta i kërkuan që të ofronte drekën e tij dhe ai do të ketë shikuar përreth, duke parë mijëra njerëz. Dhe ndoshta, si ata, do të jetë përgjigjur duke thënë: “Nuk mjafton kjo, pse po më kërkoni mua dhe nuk merreni ju me këtë gjë, që jeni nxënësit e Jezusit? Kush jam unë?”. Atëherë, ndoshta, do t'i kenë thënë se ishte vetë Jezusi që e kërkoi atë. Dhe ai bën një gjë të jashtëzakonshme: *u beson atyre*. Ai djali, që kishte drekën me vete, *u beson atyre*, jep gjithçka, nuk mban asgjë për vete. Ai kishte ardhur për të marrë nga Jezusi dhe e gjen veten duke i dhënë Jezusit, por kështu ndodh mrekullia. Lind nga bashkëndarja: shumëzimi i kryer nga Jezusi fillon me ndarjen e atij të riu me Të dhe për të tjerët. E pakta e atij djali në duart e Jezusit bëhet shumë. Këtu të çon feja: te liria për të dhënë, tek entuziazmi për të dhuruar, te tejkalimi i frikës, për t'u përfshirë! Miq, secili prej jush është i çmuar për Jezusin, edhe për mua! Kujtohu se askush nuk mund të zërë vendin tënd në historinë e botës, në historinë e Kishës, askush nuk mund ta zërë vendin tënd, askush nuk mund të bëjë atë që vetëm ti mund të bësh. Atëherë ta ndihmojmë veten për të besuar se jemi të dashur dhe të çmuar, se jemi krijuar për gjëra të mëdha. Të lutemi për këtë dhe ta inkurajojmë veten tonë për një gjë të tillë! Dhe kujtohuni të luteni për mua. *Köszönöm!* [Faleminderit!]





PAPA UNIVERSITARËVE: KULTURA DUKE U ZHYTUR NË BRAZDATE REALITETIT, JEP FRYTE

Fjala e Atit të Shenjtë: *Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe i Shkencave Bionike të Universitetit Katolik “Péter Pázmány” (Budapest), e diel, më 30 prill 2023*

Udhëtimi apostolik i Shenjtërisë së tij Françeskut në Hungari, (28 - 30 prill 2023)

Të dashur vëllezër e motra, mirëdita!

Përsëritës secilin prej jush dhe ju falënderoj për fjalët e bukura që keni thënë, tek të cilat do të ndalem pas pak. Ky është takimi i fundit i vizitës sime në Hungari dhe, me një zemër mirënjohëse, më pëlqen të mendoj për rrjedhën e Danubit, i cili e lidh këtë vend me shumë të tjerë, duke bashkuar, përveç gjeografisë, edhe historinë e tyre. Kultura, në njëfarë kuptimi, është si një lumë i madh: lidh dhe përshkon rajone të ndryshme të jetës dhe të historisë duke i ndërlidhur ato, mundëson lundrimin nëpër botë dhe përqafimin e vendeve dhe të tokave të largëta, ushqen mendjen, ujit shpirtin, rrit shoqërinë. Vetë fjala *kulturë* rrjedh nga folja *kultivoj*: dija kërkon një mbjellje të përditshme e cila, duke u zhytur në brazdat e realitetit, jep fryte.

Njëqind vjet më parë Romano Guardini, një intelektual i madh dhe besimtar, pikërisht ndërsa ndodhej i zhytur në një peisazh të bërë unik nga bukuria e ujërave, pati një intuitë të frytshme

kulturore. Shkroi: «Këto ditë kam kuptuar më shumë se kurrë se ekzistojnë dy forma të dijes [...], njëra të çon që të zhytesh në objekt dhe në kontekstin e tij, për këtë arsye njeriu që dëshiron të dijë përpiqet të jetojë në të; tjetra, përkundrazi, i mbledh gjërat, i zbërthen, i rendit në kuti, i zotëron dhe i ka në nëdorësi, i sundon» (*Lettere dal Lago di Como. La tecnica e l'uomo [Letra nga Liqeni i Komos. Teknika dhe njeriu]*, Brescia 2022, 55). Bën dallimin midis një njohurie të përlulur dhe marrëdhënore, e cila është si “një mbretërim që fitohet me anë të shërbimit; një krijim sipas natyrës, që nuk shkon përtej limiteve të vendosura” (shih f. 57), dhe një mënyrë tjetër dije, e cila “nuk vëzhgon, por analizon [...] nuk zhytet më në objekt, por e rrok atë” (f. 56).

Në këtë mënyrë të dytë të njohjes “energjitë dhe substancat konvergojnë në një qëllim të vetëm: makina” (f. 58), dhe “kështu zhvillohet një teknikë që nënshtron qenien e gjallë” (f. 59-60). Guardini





nuk e demonizon teknologjinë, e cila na mundëson që të jetojmë më mirë, të komunikojmë dhe të kemi shumë përparësi, por paralajmëron rrezikun që ajo të bëhet rregullatorja, madje edhe sunduesja, e jetës. Në këtë kuptim ai pa një rrezik të madh: «Njeriu i humbet të gjitha lidhjet e brendshme që i japin një ndjenjë organike të masës dhe të formave të shprehjes në harmoni me natyrën» dhe, «ndërsa në qenien e brendshme ai është bërë pa konture, pa masë, pa drejtim, ai vendos në mënyrë arbitrare qëllimet e tij dhe i detyron forcat e natyrës, të sunduara prej tij, që t'i vënë në jetë ato» (f. 60). Dhe linte një pyetje shqetësuese për pasardhësit: «Çfarë do të bëhet me jetën nëse ajo përfundon nën këtë zgjedhje? [...] Çfarë do të ndodhë [...] kur do të gjendemi përballë mbizotërimit të imperativave të teknologjisë? Jeta, tanimë, është futur në një sistem makinerish. [...] Në një sistem të tillë, a mund të mbetet jeta e gjallë?» (fq. 61).

A mund të mbetet jeta e gjallë? Është një pyetje që, sidomos në këtë vend, ku studiohet në thellësi teknologjia e informacionit dhe “shkencat bionike”, është mirë të shtrohet. Në fakt, ajo që ka parë Guardini duket qartë në ditët tona: të mendojmë për krizën ekologjike, me natyrën që thjesht po reagon ndaj përdorimit instrumental që i kemi bërë. Të mendojmë për mungesën e limiteve, për logjikën e “mund të bëhet, prandaj është e lejuar”. Të mendojmë gjithashtu edhe për dëshirën për të vënë në qendër të gjithçkaje jo personin dhe marrëdhëniet e tij, por individin e përqendruar te nevojat e veta, të etur për të fituar dhe të pangopur për ta kapur realitetin. Dhe për rrjedhojë të mendojmë për gërryerjen e marrëdhënieve bashkësiore, ku vetmia dhe frika, nga kushte ekzistenciale, duket se po shndërrohen në kushte sociale. Sa individë të izoluar, shumë “social” dhe jo shumë socialë/shoqërorë, i drejtohen, si në një rreth vicioz, ngushëllimeve të teknologjisë për të mbushur boshllëkun që ndjejnë, duke vrapuar në një mënyrë edhe më të furishme, ndërsa i janë nënshtruar një kapitalizmi të egër, i ndjejnë më të dhimbshme dobësitë e tyre, në një shoqëri ku shpejtësia e jashtme shkon paralelisht me brishtësinë e brendshme. Kjo është drama. Duke thënë këtë, nuk dua të përhap pesimizëm – do të ishte në kundërshtim me fenë të cilën me gëzim shpall – por të reflektojmë mbi “fodullëkun e të qenit dhe të të pasurit”, të cilin që në agimet e kulturës evropiane Homeri e shihte si kërcënues dhe që paradigma teknokratike e përkeqëson, me një përdorim të caktuar të algoritmeve që mund të përfaqësojnë një rrezik të mëtejshëm të destabilizimit të njeriut.

Në një roman që e kam përmendur disa herë, “*Il padrone del mondo*” (Zoti i botës), të Robert Benson-it, vërehet se “kompleksiteti mekanik nuk

është sinonim i madhështisë së vërtetë dhe se në pamjen e jashtme më luksoze fshihet rreziku më i hollë” (Verona 2014, 24-25). Në këtë libër, në njëfarë kuptimi “profetik”, shkruar më shumë se një shekull më parë, përshkruhet një e ardhme e sunduar nga teknologjia dhe në të cilën gjithçka, në emër të përparimit, është e standardizuar: kudo predikohet një “humanitarizëm” i ri që anulon dallimet, duke eliminuar jetët e popujve dhe duke shfuqizuar fetë. Duke shfuqizuar dallimet, të gjitha dallimet. Ideologjitë kundërshtarë konvergojnë në një homogenizim që *kolonizon ideologjikisht*. Kjo është drama, kolonizimi ideologjik; njeriu, në kontakt me makinat, rrafshohet gjithnjë e më shumë, ndërsa jeta e përbashkët bëhet e trishtuar dhe e rrallë. Në atë botë të përparuar, por të zymtë të përshkruar nga Benson-i, ku të gjithë duken të mpirë dhe të anestezuar, duket diçka normale t'i flakësh të sëmurët dhe të zbatosh eutanazinë, si dhe t'i heqësh gjuhët dhe kulturat kombëtare për të arritur pagën universale, e cila në realitet kthehet në një përmdekje të bazuar në imponimin e pëlqimit, aq sa t'i bëjnë një protagonistin të pohojë se «bota duket në mëshirën e një vitaliteti pervers, që korrupton dhe ngatërron gjithçka» (f. 145).

E kam vazhduar këtë shqyrtim me tone të zymta, sepse pikërisht në këtë kontekst shkëlqejnë më së miri rolet e kulturës dhe të universitetit. Universiteti është në fakt, siç tregon edhe vetë emri, vendi ku lind, rritet dhe piqet mendimi i *hapur dhe simfonik*; jo monokord, jo i mbyllur: i hapur dhe simfonik. Është “tempulli” ku dija thirret të lirohet nga kufijtë e ngushtë të të pasurit dhe të zotërimit për t'u bërë kulturë, pra “kultivim” i njeriut dhe i marrëdhënieve të tij themeluese: me transhendentin, me shoqërinë, me historinë, me krijimin. Në këtë drejtim, Konkili i Dytë i Vatikanit pohon: «Kultura duhet të synojë përsosjen integrale të personit njerëzor, në të mirën e bashkësisë dhe të gjithë shoqërisë njerëzore. Prandaj është e nevojshme të *kultivohet shpirti* në mënyrë që të zhvillohen aftësitë e admirimit, të intuitës, të soditjes dhe njeriu të bëhet i aftë për të formuar një gjykim personal dhe *për të kultivuar ndjenjën fetare, morale dhe shoqërore*” (Kushtetuta Baritore *Gaudium et spes*, 59). Që në lashtësi thuhej se fillimi i filozofimit është admirimi, aftësia për të admiruar. Nga këtë këndvështrim, i kam vlerësuar shumë fjalët tuaja. Tuajat, Imzot Rektor, kur thatë se «te çdo shkencëtar i vërtetë ka diçka nga skribi, prifti, profeti dhe mistiku»; dhe përsëri se “me ndihmën e shkencës nuk duam vetëm të kuptojmë, por duam të bëjmë edhe gjënë e duhur, domethënë të ndërtojmë një qytetërim njerëzor dhe solidar, një kulturë dhe një mjedis të qëndrueshëm. Me zemër të përlulur mund të ngjitemi jo vetëm në malin e Zotit, por edhe në malin e shkencës”.



Është e vërtetë: intelektualët e mëdhenj, në fakt, janë të përlurur. Misteri i jetës, nga ana tjetër, u zbulohet atyre që dinë të futen në gjërat e vogla. Në këtë drejtim, ajo që na tha Dorottya është e bukur: “Duke zbuluar gjithnjë e më shumë detaje të vogla, zhytmi në kompleksitetin e punës së Zotit”. E kuptuar në këtë mënyrë, kultura përfaqëson me të vërtetë mbrojtjen e njerëzores. Ajo zhytet në soditje dhe formon njerëz që nuk janë në mëshirën e modës së momentit, por të rrënjësuar mirë në realitetin e gjërave. Dhe të cilët, nxënësit të përlurur të dijes, ndiejnë se duhet të jenë të hapur dhe komunikues, kurrë të ngurtë dhe luftarakë. Ai që e do kulturën, në fakt, nuk ndihet kurrë i arritur dhe të rregull, por ruan brenda vetes së vet një shqetësim të shëndetshëm. Hulumton, pyet, rrezikon, eksploron; di si të dalë nga siguritë e veta për të hyrë me përlulësi në misterin e jetës, i cili kombinohet me shqetësimin, jo me zakonin; u hapet kulturave të tjera dhe ndjen nevojën për t’i ndarë njohuritë me to. Ky është shpirti i universitetit dhe ju falënderoj që e jetoni në këtë mënyrë; siç na tha profesor Major-i, i cili na tregoi për bukurinë e bashkëpunimit me realitete të tjera edukative, përmes programeve të përbashkëta kërkimore dhe gjithashtu duke mirëpritur studentë nga rajone të tjera të botës, si Lindja e Mesme, veçanërisht nga Siria e martirizuar. Duke u hapur ndaj të tjerëve ne e njohim më mirë veten tonë. Hapja, hapja ndaj të tjerëve është si një pasqyrë: më bën ta njoh më mirë veten time.

Kultura na shoqëron për ta njohur veten tonë. Mendimi klasik, i cili nuk duhet të përdoret kurrë, na e kujton atë. Më vijnë ndërmend fjalët e famshme të orakullit të Delfit: “Njih vetveten”. Është njëra nga dy fjalitë udhëzuese që do të doja t’ju lë tani në fund. Por çfarë do të thotë *të njohësh vetveten*? Do të thotë të dish t’i njohësh limitet e tua dhe, rrjedhimisht, të përmbash mendjemadhësinë e vetëmjaftueshmërisë. Na bën mirë, sepse, mbi të gjitha, duke e njohur veten si krijesa, ne bëhemi kreativë, duke u zhytur në botë në vend që ta sundojmë atë. Dhe ndërsa mendimi teknokratik ndjek përparimin që nuk pranon limite, njeriu real përbëhet edhe nga brishtësia, dhe shpesh është pikërisht aty ku ai kupton se është i varur nga Zoti dhe i lidhur me të tjerët dhe me krijimin. Prandaj fjalia e orakullit të Delfit na fton në një njohje që, duke u nisur nga përlulësia, duke u nisur nga limitet, duke u nisur nga përlulësia e limitit zbulon potencialin e vet të mrekullueshëm, i cili shkon shumë përtej atij teknik. Me fjalë të tjera, njohja e vetvetes kërkon të mbajë

së bashku, në një dialektikë të virtytshme, brishtësinë dhe madhështinë e njeriut. Nga mrekullimi i këtij kontrasti lind kultura: asnjëherë e plotë dhe gjithmonë në kërkim, e shqetësuar dhe bashkësiore, e disiplinuar në fundshmërinë e saj dhe e hapur ndaj absolutes. Ju uroj që ta kultivoni këtë zbulim emocionues të së vërtetës!

Fraza e dytë udhëzuese i referohet pikërisht të vërtetës. Është një fjali e Jezu Krishtit: “*E vërteta do t’ju bëjë të lirë*” (Gjn 8,32). Hungaria ka parë një sërë ideologjish që u imponuan si të vërteta, por nuk jepnin liri. Dhe edhe sot rreziku nuk është zhdukur: mendoj për kalimin nga komunizmi në konsumizëm. Ajo që i bashkon të dy “izmat” është një ide e urre e lirisë; ajo e komunizmit ishte një “liri” e detyruar, e kufizuar nga jashtë, e vendosur nga dikush tjetër; ajo e konsumizmit është një “liri” libertine, hedoniste, e rrafshët, që na bën skllevër të konsumit dhe të gjërave. Dhe sa e lehtë është të kalosh nga kufijtë e vendosur mbi të menduarit, si në komunizëm, në të menduarit pa limite, si në konsumizëm! Nga një liri të frekuar në një liri pa frenë. Në vend të kësaj, Jezusi ofron një rrugëdalje, duke thënë se ajo që është e vërtetë liron, ajo që e liron njeriun nga varësitë dhe mbylljet e tij. Çelësi për ta arritur këtë të vërtetë është një njohje që nuk është kurrë e shkëputur nga dashuria, marrëdhënore, e përlurur dhe e hapur, konkrete dhe e përbashkët, e guximshme dhe konstruktive. Kjo është ajo që Universitetet janë të thirrur të kultivojnë dhe feja të ushqejë. Prandaj uroj që ky dhe çdo Universitet të jetë një qendër universaliteti dhe lirie, një kantier i frytshëm i humanizmit, një laborator shprese. Ju bekoj nga thellësia e zemrës dhe ju falënderoj për gjithçka që bëni. Faleminderit shumë!





KUR PËR PASHKË NUK BININ KËMBANAT

*Dëshmia e Kardinalit shqiptar Ernest Simoni bërë pranë Papës
më rastin e bekimit "Urbi et Orbi" nga lozha e Bazilikës së Shën Pjetrit, dt. 13 prill 2023.*

Krishti u ngjall, aleluja! Krishti është ngjallur me të vërtetë, sot si dy mijë vjet më parë, dhe e dhuroi vetveten si shlyerje për mëkatet tona, me qëllim që ta shpëtojë mbarë njerëzimin. Në këtë ditë solemne, më e rëndësishmja e vitit liturgjik, të jem pranë Atit të Shenjtë, me rastin e mesazhit të Pashkës dhe të bekimit *Urbi et Orbi*, t'i dëgjoj fjalët e tij dhe thirrjen për paqe ka qenë një hir i madh dhe një dhuratë e papërshkrueshme për mua.

kujtohet se motoja e diktatorit ishte: nëse nuk e zhdukim klerin katolik, nuk do të fitojmë kurrë. Për këtë arsye, kishat ishin shkatërruar ose përdorëshin për diçka tjetër dhe këmbanaret ishin shembur.

Ditën e Pashkës dhe ditët në vijim, në kampin e punës dhe në burg, fshehurazi mes të krishterëve, duke rrezikuar të vareshim, shkëmbehim paqen e të Ngjallurit duke shtrënguar duart dhe duke përsëritur me zë të ulët: "Krishti u ngjall!" . Sa



Papa më ka shprehur vlerësimin e tij për dëshminë e fesë bërë gjatë viteve të përndjekjes nga regjimi komunist. Kjo mirënjohje ka qenë një hir edhe për krejt Shqipërinë time të dashur. Si mund të mos mendoj për sivëllezërit e mi dhe për të krishterët e shumë që, duke e mbartur Kryqin në Kalvar gjatë përndjekjes për urrejtje ndaj fesë, kanë dhuruar deri edhe jetën e tyre duke ndjekur premtimin e të Ngjallurit, që u paraprin dhe na paraprin në Jerusalemin qiellor.

Në Shqipëri, në kohën e diktaturës komuniste, këmbanat nuk kumtonin më festën e Pashkës. Më

gëzim ndienim duke e përsëritur këtë të vërtetë! Disa roje burgu e kishin vënë re se kjo ishte mënyra jonë për ta kremtuar Pashkën, edhe pse ishim në burg. Megjithatë, atë ditë as nuk na rrihnin dhe as nuk na paditnin te eprorët, sepse ishin të rinj që rridhnin nga familje të krishtera, të frikësuar prej kërcënimeve të regjimit dhe për këtë arsye të detyruar t'i përndiqnin vëllezërit e tyre.

Kremtimi i festës së Pashkës pranë Papës këtë vit ishte një nder dhe një gëzim për mua. Jezusi është ngjallur me të vërtetë, sepse asnjëherë gjatë regjimit në Shqipëri nuk do ta kisha menduar se



ishte e mundur ta shoqëroja Papën te Lozha e Bekimit.

Nuk e kisha menduar kurrë se do të bëhesha kardinal. Ka qenë një dhuratë e madhe për mua, për të cilën nuk do të resht së falënderuari me gjithë zemër Papa Françeskun. Nuk do ta kisha besuar kurrë këtë kur më rrihnin apo kur m'i shtrëngonin prangat rreth kyçeve të duarve. Nuk do ta kisha imagjinuar kurrë, pasi u detyrova të hiqja dorë nga mbarështimi meshtarak dhe nga shërbimi mes besimtarëve, se do të isha në gjendje të ndaja gëzimin e Pashkës me krejt Kishën dhe së bashku me pasardhësin e Pjetrit apostull. Mendoj se ky është një hir jo vetëm për mua, por për të gjithë ata që kanë qenë viktimë të urrejtjes e të përndjekjes dhe nuk ia kanë dalë. Duke më përshëndetur, Ati i Shenjtë i ka kujtuar përsëri ata: shumë të krishterë - meshtarë, rregulltarë, rregulltare e laikë - të shpallur të Lumë në vitin 2016, me vullnet të Papa Françeskut.

Pikërisht ditën e Pashkës, siç kemi dëgjuar, Papa i foli popullit të Romës dhe të botës, duke ngritur edhe një herë zërin e tij për t'i thirrur njerëzit dhe në veçanti bashkësinë ndërkombëtare që të bëhen punëtorë të paqes dhe jo të shkatërrimit, që t'i shuajnë konfliktet që po gjakosin botën.

Në mesazhin e tij ai kërkoi ndihmën e Krishtit të Ngjallur, që ta mbështesë popullin ukrainas në mënyrë që ta gëzojë paqen e kërkuar dhe ta përhapë dritën e Pashkës mbi popullin rus. Ati i Shenjtë kujtoi gjithashtu Sirinë e martirizuar, e cila ende nuk e ka gjetur rrugën për t'i dhënë fund armiqësive. Papa u shprehu solidaritetin dhe afërsinë e tij atyre që vuajnë nga lufta: të plagosurve, familjeve, të burgosurve. Dhe na nxiti që t'i lutemi Zotit, me qëllim që Ai t'i mbështesë të prekurit nga tërmeti i dhunshëm në Turqi dhe në Siri, duke u lutur për viktimat dhe për ata që kanë humbur familjen dhe miqtë e tyre.

T'i meditojmë fjalët dhe nxitjet atërore të Atit të Shenjtë: "Jezusi, i Gjalli, është gjithmonë me ne". Ta lëmë veten të mrekullohemi nga kumtimi i gëzuar i Pashkës, nga drita që ndriçon errësirën dhe terret në të cilat gjendet shumë shpesh e mbështjellë bota. Të ndjekim shembullin e Papës, t'i kthejmë zemrat tona dhe t'i vëmë në praktikë mësimet e tij të përditshme. Të lutemi për Papën, që Zoti t'i japë gjithmonë shëndet, forcë dhe hir për ta udhëhequr Barkën e Pjetrit në kohët tona të errëta dhe të kërcënuara nga luftërat, zitë e bukës dhe nga shekullarizimi që po përhapet mes njerëzve. E përjetofshim dhuratën e fesë dhe i gëzofshim premtimet e Jezusit të ngjallur sot nga errësira e vdekjes për shpëtimin tonë.

Nga Dom Ernest Simoni

Kardinal diakon i Shenjtes Mari të Shkallës





DIKTATURA SHKATËRRON PASHMANGSHMËRISHT NDËRGJEGJET E NJERËZVE

*Pretku i mbajtur nga Imzot Angelo Massafra me rastin e
30-vjetorit të Meshës së Papa Gjon Palit II në Katedralen e Shkodrës
1993 - 25 prill - 2023*



Qofte levduar Jezu Krishti!

Ndërsa Kisha universale kremton festën e Shën Markut Ungjilltar, Kisha jonë e Shqipërisë përkujton një ngjarje të rëndësishme historike: vizitën apostolike të Shën Gjon Palit II dhe shugurimin e ipeshkvijve të parë pas ardhjes së demokracisë në vendin tonë.

Kujtimi i këtij përvjetori nuk mund të jetë thjeshtë një datë në kalendar, por ka për detyrë që të sjellë në kujtesën e mendjes dhe të zemrës domethënien e asaj ngjarje të atë që e jetuan dhe që t'u transmetojë atyre që nuk kishin lindur ende, por që sot e kremtojnë këtu së bashku me ne, përmbajtjen e saj më të thellë.

Shën Gjon Pali II, si njohës i mirë i pasojave të rënda që çdo formë diktature shkakton pashmangshmërisht te ndërgjegjet e njerëzve, deshi të ishte i pranishëm në mesin e popullit tonë si udhërrëfyes shpirtëror i Kishës Katolike, ashtu

edhe si udhëheqës i njohur botërisht, për t'u dhënë shpresë atyre që sapo kishin rifituar lirinë e tyre pas shumë vitesh shtypje.

Dhe fjalët që ai tha në atë ditë të paharrueshme ndihem i detyruar t'i citoj sot gjatë kësaj homelie, sepse ato përfaqësojnë thelbin e mesazhit të tij dhe përshkruajnë kuptimin e veprës apostolike që është kryer nga Kisha Katolike në Shqipëri gjatë këtyre tridhjetë viteve. Ai tha: *“Nuk duhet ta harroni atë që ndodhi! Është e drejtë që të shikoni gjithmonë përpara për të ndërtuar një të ardhme të lirë dhe në masën e njeriut; por, është e nevojshme edhe që të keni parasysh përvojën e kaluar, për të shmangur përsëritjen e të njëjtave gabime të një periudhe kaq të tmerrshme. Ajo që ka ndodhur në Shqipëri është diçka që nuk është shënuar kurrë në histori. (...) Por kur gjithçka dukej e humbur, ishte pikërisht atëherë që erdhi çlirim!”*

Të dashur vëllezër dhe motra, kjo ka qenë puna e Kishës sonë gjatë gjithë këtyre viteve; punë që



nuk ka mbaruar ende, por duhet të kemi parasysh se rreziku i harresës është gjithnjë aty. Është e drejtë që brezat e rinj të ecin përpara drejt së ardhmes... dhe kjo vlen edhe për ne! Por jo pa pasur parasysh të kaluarën. Në fakt, siç thuhej dikur, nëse historia nuk është “mësuese e jetës”, atëherë realisht rrezikojmë të përsërisim të njëjtat gabime.

Dhe ndoshta nuk po e konsiderojmë mjaftueshëm rrezikun e diktaturave të reja e më të fshehta... duke filluar nga diktaturat dixhitale dhe mediatike në të cilat jemi zhytur dhe që na skllavërojnë pa e kuptuar. Shën Pjetri, në leximin e parë të kësaj Meshe, na kujtoi këtë: *“Jini të përkormë dhe rrini zgjuar! Armiku juaj, djalli, porsi luan uluritës, endet këndeje dhe andej duke kërkuar (kë) të përprijë. Të fortë në fe kundërshtoni duke e ditur se po të njëjtat vuajtje i pësojnë vëllezërit tuaj në fe të shpërndarë nëpër botë”* (1 Pjt 5,8-9).

Dhe Papa e mbylli fjalën e tij duke thënë: *“E dashur Kishë, Bashkësi Katolike e Shqipërisë, ji e sigurt dhe shikoje të ardhmen tënde me optimizëm! Ashtu si në të kaluarën ke ditur t'i qëndrosh besnike të vetmit Zot Jezu Krisht, edhe me çmimin e sakrificës supreme të jetës, ji e gatshme tani që ta pranosh me gatishmëri Ungjillin e dashurisë hyjnore dhe t'i dëshmosh me guxim të gjitha kërkesat e tij. Jep shembullin e një dashurie pa kushte, të një dashurie që shkon përtej ofendimeve dhe që madje, duke i harruar ato, është gati të falë përndjekësit e vet”*.

Edhe kjo vepër e mëshirës së faljes është çuar përpara me bujari nga Kisha Katolike.

Duke filluar nga Martirët që falnin para se të pushkatoheshin. Edhe Meshtarët dhe rregulltarët e mbijetuar që kam takuar dhe që personalisht kam njohur i kanë falur torturuesit e tyre (roje dhe torturues), ja disa shembuj:

Atë Daniel Dajani: *“I fal të gjithë ata që më kanë bërë keq. Jam i lumtur që po vdes i pafajshëm dhe jo fajtor. Prindërit e mi duhet t'i japin Dom Zef Shllakut ofertë për dy Meshë”*;

Mark Çuni: *“I fal të gjithë ata që më gjykuan, që më dënuan dhe ata që janë përgjegjës për ekzekutimin tim. Thuajini nënës sime që të paguajë një borxh prej 15 napolonash që i kam Ludovik Rashës. Rroftë Krishti Mbret dhe Rroftë Shqipëria”*;

Qerim Sadiku: *“I fal të gjithë ata që në çdo moment më kanë bërë keq. I fal edhe ata që më dënuan me vdekje dhe ata që do të më ekzekutojnë. Rroftë Krishti Mbret dhe Rroftë Shqipëria”*.

Po ashtu, sa herë e kemi bërë veten mjete

pajtimi dhe paqeje! Sa herë ua kemi mbyllur gojën instinkteve të hakmarrjes dhe të gjakmarrjes! Sa familje ka pajtuar dhe vazhdon të pajtojë Kisha Katolike, me meshtarët dhe laikët e saj më të përkushtuar.

Të dashur vëllezër e motra, mandatin e të Ringjallurit e kemi dëgjuar sërish sot nga goja e Shën Markut: *“Dilni”, “Pagëzoni”, “Dëboni djajtë”, “Flisni gjuhë të reja”, “Shëroni të sëmurë”* (Mk 16,15-18): me të vërtetë puna e Kishës duhet të realizohet sipas këtyre parametrave ungjillorë. Prandaj, detyra jonë e parë kishtarë (dhe nënkuptoj Kishën si një e tërë me barinj, rregulltarë, rregulltare dhe laikë, në shpirtin e Sinodit që po përjetojmë) është ta vazhdojmë veprën e Krishtit, i cili *“përshkoi vendin duke bërë mirë dhe duke shëruar të gjithë”* (Vap 10,38). Sfida të reja na dalin përpara:

“Dilni”: sfida misionare që nuk lejon kërkimin e rehative tona;

“Pagëzoni”: jo aq aspekti ritual, sesa sfida e ungjillizimit të ri;

“Dëboni djajtë”: sfida e shoshitjes për ta dalluar të keqen dhe për ta denoncuar atë;

“Flisni gjuhë të reja”: sfida e areopagëve të rinj, e vendeve dhe e gjuhëve të reja të kumtimit;

“Shëroni të sëmurë”: sfida e një mëshirë të përtërirë ndaj të plagosurve të kohës sonë.

Dhe nëse mandati i Gjon Palit II dhënë Kishës në Shqipëri tridhjetë vjet më parë kaloi përmes Ipeshkvijve që shuguroi më 25 prill (i kujtojmë me dashuri: Frano Illinë, Zef Simonin, Rrok Mirditën dhe Robert Ashtën), ai mandat sot i ripërtërihet një Kishe në të gjithë përbërësit e saj: çdo i pagëzuar, pavarësisht nga roli që luan brenda bashkësisë kishtarë, duhet të ndihet i veshur me këtë mandat dhe të angazhohet për ta përmbushur atë.

Vëllezër e motra, na takon neve detyra e mrekullueshme e realizimit dhe e ndërtimit të Kishës në këtë kohë. E urojmë sinqerisht këtë gjë dhe kërkojmë mbështetjen e Marisë Shumë të Shenjtë, Nënës së Këshillit të Mirë, të Shenjtes Nënë Terezë të Kalkutës dhe të Martirëve tanë të Lumë të Shqipërisë. Në fakt, detyra që na pret nuk do të jetë pa vështirësi, por do të jetë edhe plot me kënaqësi në Zotin.

E mbyll me të njëjtat fjalë që dëgjuam nga Shën Pjetri sot: *“Hyji, burimi i çdo hiri, i cili ju grishi në lumturinë e vet të amshuar në Jezu Krishtin, Ai, mbasi të vuani për pak kohë, do t'ju përsosë, do t'ju përforcojë, do t'ju japë fuqi dhe do t'ju bëjë të patrandshëm. Ai sundoftë në shekuj të shekujve. Amen!”* (1 Pjt 5,10).



NË MARINË, KISHA E BASHKUAR TE KËMBËT E KRYQIT

“Grua, qe, yt bir... Qe, nëna jote!” (Gjn 19,26-27).

*Pretku me rastin e fillimit të muajt të Zojës së Shkodrës,
në Kishën rrëze kalas Rozafat në Shkodër, mbajtur nga Imzot Angelo Massafra, dt.1 maj 2023*

Le ta fillojmë muajin kushtuar devocionit ndaj Zojës së Bekuar në këtë Shenjtërore kushtuar Nënës së Këshillit të Mirë dhe Zonjës së Shkodrës; muaj që fillon me përkujtimin e Shën Jozefit, të fejuarit të saj dhe mbrojtësit të Kishës universale. Është bukur që fillimi i një kohe kaq të dashur për traditën katolike na bën t'i shikojmë Marinë dhe Jozefin njëkohësisht, ndërsa ata na tregojnë qendrën dhe qëllimin e krejt devocionit tonë: Jezusin.

Në fakt, çdo devocion, nëse nuk na çon te Jezusi, nuk do të jetë kurrë një devocion i vërtetë. Vetë Jezusi na e ka thënë këtë në Ungjillin që sapo shpallëm: “Profeti ndahet pa nder vetëm në vendin e vet, në faretin e vet dhe në shtëpinë e vet” (Mk 6,4). Të përbuzësh do të thotë “të zhvlerësosh”, të ulësh vlerën e dikujt... dhe shumë shpesh, në sferën fetare, rrezikojmë të ulim vlerën e asaj që është thelbësore për fenë tonë për të ndjekur atë që duhet të na ndihmojë vetëm që të rritemi në fe. Prandaj, devocioni i vërtetë është një ndihmë për fenë tonë, por nuk mund ta zëvendësojë atë.

Na mësofshin Maria dhe Jozefi gjatë këtij muaji të shkojmë te gjërat thelbësore, ta duam Zotin “me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde” (Mt 22,37); na mësofshin të jemi Kishë, bashkësi e Krishtit të ringjallur lindur te këmbët e Kryqit.

Të mos na duket i çuditshëm ky pohim: Ungjilli i Gjonit, në fakt, na ofron mësim të mrekullueshëm për figurën e Shpirtit Shenjt në jetën e nxënësve, dhe për rrjedhojë të Kishës, por nuk gjejmë referenca për Rrëshajën siç tregojnë Luka ungjilltar në Veprat e Apostujve ose siç sugjerojnë Ungjijtë e tjerë në tregimin e Ngjitjes në qiell. Dhënia e Shpirtit Shenjt, sipas Ungjillit të Gjonit, bëhet kryesisht në momentin e vdekjes së Jezusit në kryq kur thotë: “Dha shpirt” (Gjn 19,30).

Vetëm më vonë, gjatë shfaqjes para nxënësve të bashkuar në çenakull / dhomën e sipërme, Jezusi do të thotë shprehimisht: “Merrni Shpirtin Shenjt” (Gjn 20,22). Nga kjo kuptojmë se Shpirti Shenjt është dhuratë pashkore e Krishtit për Kishën e tij dhe krijon Kishën. Dhe kush ishte i pranishëm te këmbët e Kryqit kur Jezusi dha Shpirtin? Nëna me gratë e tjera dhe Gjoni. Atyre Jezusi u kishte drejtuar ato fjalë shumë të rëndësishme: “Grua, qe, yt bir... Qe, nëna jote!” (Gjn 19,26-27). Një



dorëzim i ndërsjellë, një lidhje e pazgjidhshme që duhet të vazhdojë gjithmonë deri në fund të kohës. Dhe kush ishte i pranishëm në çenakull kur Jezusi u shfaq mbremjen e Pashkës? Nëna dhe nxënësit.

Kisha e Krishtit, pra, konfigurohet plotësisht me Nënë e Jezusit me të cilën është e bashkuar. Është i rëndësishëm dhe i bukur mësimi i Konkilit të Dytë të Vatikanit: “(Maria) është «me të vërtetë nëna e gjymtyrëve (të Krishtit)... sepse ajo bashkëpunoi me dashurinë hyjnore në lindjen e besimtarëve të Kishës, të cilët janë gjymtyrë të asaj koke». Për këtë arsye ajo njihet edhe si një gjymtyrë e shquar dhe krejtësisht unike e Kishës, figurë dhe model i shkëlqyer për të në fe dhe dashuri; dhe Kisha Katolike, e udhëzuar nga Shpirti Shenjt, me dashuri devocioni birmor e nderon atë si një nënë shumë të dashur”.

Prandaj, gjatë këtij muaji, të ndihmuar nga ipeshkvijtë tanë që do të jenë me radhë në këtë altar, do të reflektojmë për qenien tonë Kishë, për ta jetuar më mirë kohën e Sinodit që jemi duke kremtuar. Por sot reflektimi ynë na vë te këmbët e Kryqit dhe ne jemi të ftuar që ta njohim veten në nxënësin e dashur që e mikpret Nënë dhe e merr me vete atë.

Çdo Eukaristi që kremtojmë është një përkujtim i vdekjes dhe i ringjalljes së Jezusit: prandaj është edhe një përkujtim i lindjes së Kishës të cilës i është dhënë dhurata e Shpirtit Shenjt. Ta kujtojmë këtë gjë dhe ta jetojmë intensivisht këtë moment liturgjik në të cilin Maria është e pranishme për të kremtuar së bashku me ne dhe na ndihmon përsëri që të jemi nxënës besnikë të Birit të saj Jezus dhe të Zotit tonë, të cilit i qoftë lavdi, nderi dhe lavdia për të gjithë shekujt e shekujve. Amen.



FTESA E MARISË PËR TË BËRË ATË QË JEZUSI NA THOTË TË BËJMË!

*Pretku i mbajtur nga Imzot Angelo Massafra në
Shenjtërorën e Zojës së Këshillit të Mirë, Shkodër, 26/04/2023*



Të dashur Vëllezër dhe Motra,

Jemi mbledhur sot në këtë vend, pas ftesës së Marisë: “*Bëni gjithçka t’ju thotë*” (Gjn 2,5), një nga fjalët e pakta që thotë Nëna e Jezusit në Ungjij. Një urdhër, një “Këshillë e Mirë”, që ajo nuk pushon kurrë së dhëni nxënësve të Birit të saj.

Kështu ne, Ipeshkvijtë e Shqipërisë - i përshëndes të gjithë, një nga një, duke i falënderuar për praninë e tyre këtu sot, ashtu siç ju përshëndes të gjithëve - erdhëm në shtegtim në këtë vend që tridhjetë vjet më parë, mes rrënojave të lëna nga diktatura, pa Shën Gjon Palin II dhe dëgjoi lutjen e tij për popullin shqiptar.

Ai, në atë rrethanë, nuk mbajti fjalime, por u përqendrua në një lutje të heshtur, që vetëm zemra e Nënës së Qiellit e dëgjoi dhe me siguri ia drejtoi Zemrës së Birit të saj të dashur Jezus: lutje ndërmjetësimi për këtë Kishë në aktin e ringjalljes pas mundimeve të saj të dhimbshme.

Dje, në katedralen e Shkodrës, përkujtuam atë Vizitë Apostolike të tridhjetë viteve më parë dhe

kujtuam fjalët e Papës, që na nxiste të mos harronim të shkuarën me qëllim që të mos përsërisim të njëjtat gabime dhe të shikonim të ardhmen me shpresë dhe ndjenja falje për përndjekësit. Në të njëjtën kohë, kemi parë se si Kisha në Shqipëri ka qenë vërtet besnike ndaj këtij mandati të Gjon Palit II; një mandat që rinovohet sot duke pasur parasysh sfidat e reja, të cilat është koha t’i përballojmë të gjithë së bashku, në shpirtin e Sinodit që po kremtojmë në këtë kohë.

Nuk mund dhe nuk duhet ta lëmë këtë Sinod të bjerë në vesh të shurdhër: do të ishte sikur të linim të binte në vesh të shurdhër ftesa e Marisë për të bërë atë që Jezusi na thotë të bëjmë. Po, sepse Jezusi, sipas premtimit të tij, është aty ku është e pranishme Kisha: “*Ku janë dy ose tre të bashkuar në emrin tim, aty jam edhe unë, midis tyre*” (Mt 18,20).

Prandaj nuk do të ndalojmë së pranuari ftesën e Marisë, madje do të përfitojmë nga krejt muaji Maj kushtuar asaj për të vazhduar reflektimin tonë mbi këtë temë dhe kështu të bëjmë kalimin nga “Sinodi si ngjarje” te “Sinodin si stil kishtar”: barinj dhe



besimtarë të bashkuar në dëgjimin e zërit të Zotit për të qenë Kishë sot.

Dhe Koha liturgjike e Pashkës që jemi duke jetuar është më e përshtatshme për ta bërë këtë reflektim. Ajo na paraqet një model të Kishës gjithmonë aktual, të karakterizuar nga prania e të Ringjallurit, nga shoqërimi i Nënës së Jezusit, nga veprimi i fuqishëm i Shpirtit Shenjt: e dëgjuam në leximin e parë.

Prania e të ringjallurit është një thirrje e vazhdueshme për t'i jetuar fatkeqësitë e jetës si një kalim i detyruar për të arritur në lavdi. Kur Jezusi u shfaq në Çenakull nuk i fshehu plagët e mundimeve, por i tregoi ato në lavdi dhe ato bëhen prova e fesë së nxënësve. Kështu, udhëhiqemi ta kalojmë jetën tonë duke mos u ikur fatkeqësive, por duke i përballuar ato me guxim dhe besim.

Shoqërimi i Nënës së Jezusit në këtë proces është më i nevojshëm se kurrë, sepse ajo na kujton se sa shumë këmbëngulje nevojitet në jetë. Gjoni ungjilltar na e paraqet atë duke qëndruar drejt te këmbët e kryqit me një folje shumë të fortë latine “Stabat” (“rrinte Zoja”): është qëndrimi drejt dhe i patundur në fenë që kemi shpallur, në shpresën e atyre që dinë të presin, në dashurinë që nuk trembet përballë asgjëje.

Veprimi i fuqishëm i Shpirtit Shenjt edhe sot i “jep krahë” Kishës dhe e bën atë të fluturojë lart, siç na nxiti Papa Françesku në Vizitën e tij Apostolike të vitit 2014. Të fluturosh lart do të thotë të mos kënaqesh me pak, por të guxosh më shumë. Në fillim të demokracisë ishte e nevojshme të niseshim nga ajo pak që kishim: energjitë që kishim mezi mjaftonin për t'i shëruar plagët e popullit tonë; por tani është koha për të guxuar më shumë!

Gjendemi përballë situatave ekstreme siç është shpopullimi, që na privon nga burimet më të mira, nga shume familje duke ecuar me shpejtësi drejt plakjes te Shqipërisë; siç janë fenomenet e

degradimit, që nuk i prisnim t'i shihnim, siç është “shitja” me çmim të ulët e vlerave tona më të rëndësishme në këmbim të “tymit”.

Te dashur vëllezër dhe Motra, por a duhet të presim gjithmonë që të tjerët të na i zgjidhin problemet tona? Rreziku është që t'ia delegojmë gjithmonë përgjegjësinë dikujt tjetër.

Si Kishë, nëse jemi vërtet të vetëdijshëm për praninë e të Ngjallurit, për shoqërimin e Marisë dhe për veprimin e fuqishëm të Shpirtit Shenjt, kemi gjithçka që na nevojitet për t'i përballuar sfidat e kohës së sotme dhe për të qenë ne vetë krijuesit e të ardhmes sonë. Është koha të ri-marrim atë që na takon: fenë tonë.

“Bëni gjithçka t’ju thotë” (Gjn 2,5): Maria ka besim në aftësinë tonë për t’iu përgjigjur urdhrat të Birit të saj; vetë Jezusi ka besim në ne nëse na beson misionin për të qenë dëshmitarë të tij dhe këtë na e kujtoi Shën Pali në leximin e dytë të kësaj feste: *“Në të edhe ne u bëmë trashëgimtarë - të paracaktuar me vendim të Atij që vepron gjithçka sipas pëlqimit të vullnetit të vet - të jemi në nder të lavdisë së tij - ne që qysh më parë e vumë shpresën në Krishtin”* (Ef 1,11-12).

Guxim, o Kishë e Krishtit në Shqipëri! Guxim Besimtarë! Forcoje besimin tënd te i Ngjalluri dhe lëviz e shtyrë nga Shpirti Shenjt. Ji e sigurt për praninë amënore të Marisë: Ajo vazhdon t’ju mbështesë me lutjet e saj, me ndërmjetësimin e saj të fuqishëm dhe me këshillat e saj. Nuk të braktisi kur ikona e saj shkoi në Gjenacan, por mbetet gjithmonë në kujtesën dhe në zemrën tënde. Fytyra e saj si Nënë ka qenë gjithmonë e pranishme sa herë ti ke kërkuar identitetin tënd gjatë përndjekjeve të ndryshme, deri në atë pikë sa të bëhej fytyra identitare e katolikëve shqiptarë, ndaj nuk do të të braktisë kurrë.

Sot, pasdreke, në Meshën e orës 18.00 në prani të Rektorit të Bazilikës së Gjenacanos, do të nënshkruajmë aktin e binjakëzimit midis dy Shenjtëroreve tona, siç bëmë javën e kaluar në Gjenacan me një nga delegacionet tona që shkuan atje për këtë arsye. Sot, është edhe më i gjerë ky “korridor”, që nuk është mbyllur kurrë me vendin ku ka gjetur strehë ikona e Zojës së Shkodrës dhe nga ku vazhdon ta shikojë Kishën në Shqipëri, Nënë dhe Mbretëreshë e të cilës është.

Asaj në këtë moment ia lartësojmë lutjen tonë dhe i themi: “T’falem Mbretëresha...”.



PSE NJË MUAJ MARIAN DHE CILA ËSHTË FIZIONOMIA E KËSAJ PËRSHPIRTËRIE?



PërsHPirtëria e krishterë

Ngjarja që ka shenjuar ndryshimin e perceptimit të pranisë së Marisë Virgjër, në jetën e Kishës dhe shprehjen e ripërtërirë në aspektin liturgjik dhe devocional, mbetet deri më sot Konkili i dytë i Vatikanit (1962-1965). Asnjë koncil tjetër nuk ka reflektuar mbi figurën e Marisë sikurse ky i fundit, *“Është hera e parë që një Koncil Ekumenik paraqet një përmbledhje kaq të gjerë të doktrinës katolike rreth vendit që Maria Virgjër zë në misterin e Krishtit dhe të Kishës. (...) Njohja e doktrinës së vërtetë katolike mbi Marinë Nënë të Zotit, përbën çelësin për një kuptim më të saktë të misterit të Krishtit e të Kishës”* (krh. S. Meo, *Concilio Vaticano II*, in NDM, 379-394).

Është folur mbi të në disa dokumente të Konkilit, por mësimi më thelbësor mbi Nënë të Hyjit është përqëndruar në Kushtetutën dogmatike *Lumen gentium* (=LG), titulluar: *“Maria në misterin e Krishtit dhe të Kishës”* (kap. VIII). Titulli i shprehur në këtë mënyrë, tejkalon atë mentalitetin i cili kuptonte dhe konsideronte Marinë autonome,

në shkëlqimin e privilegjeve të saj, për ta paraqitur të lidhur në mënyrë dinamike me Krishtin dhe me trupin e tij që është Kisha. Ky vizion i Marisë, brenda historisë së shëlbimit ka ndihmuar për të kuptuar praninë dhe misionin e saj edhe për sa i përket nderimit nga ana e Popullit të Hyjit. Ushtrimi i përsHPirtërisë ndaj Nënës së Zotit është porositur gjatë shekujve prej Magjisterit të Kishës, por është ftesë edhe e Konkilit të dytë të Vatikanit (LG 67).

Koncili i dytë i Vatikanit, si ngjarje e rëndësishme kishtarë, ndryshon mentalitetin kishtar dhe shekullar përballë jetës shpirtërore në mes rregulltarëve të thirrur në “përsosmëri” dhe besimtarëve të krishterë, laikëve të thirrur të vishen me Krishtin e të jetojnë me vetëflim thirrjen e tyre në ndikimin e Shpirtit Shenjt. Zgjerimi i rrethit nga jeta rregulltare në atë të laikëve është një shenjë e qartë e ndërrimit të perspektivës së përsHPirtërisë, fillon një “përsHPirtëri e re” e cila është nxitur vendosmërisht nga Konkili me thirrjen e gjithmbarsme në shenjtëri: *“Pra, është e dukshme*



për të gjithë, se të gjithë ata që besojnë në Krishtin, të çfarëdo gjendjeje apo rangu qofshin, janë të thirrur në plotësinë e jetës së krishterë e në përsosmërinë e dashurisë dhe se një shenjtëri e tillë nxit në shoqërinë tokësore një jetë më njerëzore. Për të arritur këtë përsosmëri besimtarët duhet t'i përdorin forcat e marra sipas masës me të cilën vetë Krishti deshi t'ua dhurojë, që, duke ndjekur shembullin e tij dhe të bërë të ngjashëm me shëmbëlltyrën e tij, në gjithçka të dëgjueshëm ndaj vullnesës së Atit, me bujari të plotë, t'i përkushtohen lavdisë së Hyjit dhe shërbimit të të afërmit. Kështu, shenjtëria e popullit të Hyjit do të rritet me frytë të begatshme, siç tregohet në mënyrë të shkëlqyer në historinë e Kishës prej jetës së shumë shenjtërve" (LG 40).

Rizbulimi dhe vlerësimi i njeriut dhe i çështjes antropologjike ka ndikuar që përshpirtëria e krishterë ashtu si sektorë të tjerë të teologjisë duhet "të përkulen me ndjeshmërinë e Marisë mbi nevojat e çdo njeriu" e të kontribuojë me mendime, me leximin e Shkrimit shenjt, me lutje, soditje, me dashuri bamirëse duke i shoqëruar besimtarët sipas planit të Hyjit. Një përshpirtëri e tillë çon në të jetuarit sipas parimeve të Mishërimit që është edhe inkulturim (krh. C. Molari, *Per una spiritualità adulta*, 218). Përshpirtëria e krishterë, për faktin se i referohet brendësisht Krishtit, Personit hyjnor të mishëruar, është thelbësisht eksperiencë interpersonale e përjetuar në soditje, në veprim e në përkushtim jo ndaj një ideje, por ndaj një Personi, madje ndaj një bashkimi Personash, sikurse është pikërisht Hyji trinitar i krishterë. Pasi të jetë kuptuar kjo përshpirtëri unike e krishterë mund të dallohet sipas aspekteve të ndryshme të jetës së të vetmit Mësues, prej të cilit frymëzohen më së pari nxënësit e tij.

Përshpirtëria mariane

Kjo hyrje e shkurtër mbi përshpirtërinë e krishterë, na nxit të pyesim mbi ekzistencën, natyrën dhe origjinalitetin e përshpirtërisë mariane. Përshpirtëria mariane është pjesë e rëndësishme dhe domethënëse e asaj që quhet *përshpirtëria e krishterë*. Përveç pranisë së Marisë në kontekstin historik e kulturor të krishtërit, përshpirtëria ndaj kësaj figure kërkon të bashkojë teologjinë me përshpirtërinë si dy elemente që pasurojnë njëra-tjetrën, sepse "një teologji pa përshpirtëri mund të rezultojë e zbrazët, ndërsa një përshpirtëri pa teologji rrezikon të jetë e verbër" (krh. B. Forte, *Dove va il cristianesimo?* 53). Një përgjigje pozitive vjen edhe nga H.U. von Balthasar: "Përshpirtëria mariane, në kuptimin më të plotë,



është identike me përshpirtërinë kishtarë, që i paraprin çdo diferencimi të karizmave të veçanta". Pra, që të jetë e ligjshme, ajo duhet të dallohet si vlerësim jetësor ku referimi Marisë bëhet në bazë të Fjalës së Hyjit dhe të eksperiencës kishtarë, por gjithmonë në mënyrë që të jetë organikisht brenda përshpirtërisë së krishterë e në funksion të saj. Prandaj, në përshpirtërinë mariane theksi vihet mbi praninë efikase të Marisë në konformimin e besimtarëve me Krishtin në Shpirtin Shenjt sipas shembullit dhe me ndihmën e Marisë së Nazaretit, e cila para të gjithëve ka jetuar këtë itinerar feje e që, si nënë dhe motër e nxënësve, ndihmon bijtë e Kishës të konformohen me Birin hyjnor-njerëzor.

Përshpirtëria mariane është një fakt kishtar. Këtë e dëshmon qartë Konkili i dytë i Vatikanit i cili e trajtoi doktrinën ndaj Virgjërës Mari jo në një dokument të veçantë, por brenda Kushtetutës dogmatike mbi Kishën. Zgjedhja e një metode të tillë ka sjell dy pasoja të rëndësishme: për të diskutuar në mënyrë komplete mbi Kishën, është e nevojshme të flitet edhe mbi Marinë; dhe për të kuptuar në mënyrë korrekte figurën e misionin e Marisë, duhet të projektohet në sfondin më të gjerë të misterit dhe të realitetit të Kishës. Kështu në këtë perspektivë, Nëna e Jezusit është një element thelbësor për Kishën. Edhe *Direktori mbi përshpirtërinë popullore* e përshkruan si: "një fakt kishtar dhe universal; besimtarët e ndiejnë shenjtërinë e papërlyer të Virgjërës e, edhe pse e nderojnë si mbretëreshë të lavdishme në qiell, janë



*të sigurtë që ajo, plot me mëshirë, ndërmjetëson për ta e prandaj e thërrasin me besim mbrojtjen e saj. Ata më të varfërit e ndiejnë veçanërisht afër. E dinë se ajo ka qenë e varfër sikur ata, se ka vuajtur shumë, se ka qenë e durueshme dhe e butë. Ndiejnë dhembshuri për dhimbjen e saj në momentin e kryqëzimit dhe të vdekjes së Birit, gëzohen me të për ngjalljen e Jezusit. Kremtojnë me gëzim festat e saj, marrin pjesë me kënaqësi në procesione, shkojnë në shtegtim në shenjtëroret kushtuar asaj, me kënaqësi këndojnë këngë në nder të saj, i ofrojnë dhurata kushtimore (krh. *Direttorio su pietà popolare e liturgia*, 183).*

Pra, përshpirtëria ndaj Nënës së Hyjit nuk dëshmohe vetëm nga lutjet e përbashkëta apo ato private, por edhe nga arkitektura, piktura, skulptura, vetrazhet, mozaiku, miniaturat, meloditë, himnet, poezitë, shenjtëroret etj. Rreth festave, vendeve e figureve të shenjta përshpirtëria popullore mariane ka zhvilluar një sërë praktikash rituale që shprehin nderimin ndaj Virgjërës Mari. Nga këto mund të përmendim: treditëshe, nëntëshe lidhur me festat mariane, muaji i majit kushtuar Marisë, lutja e rruzares dhe e *angelus*; të gjitha këto kontribuojnë për të formuar fizionominë e nderimit edhe devocional ndaj Virgjërës Mari dhe duhet të kujtojmë se këto praktika nuk janë alternative, por i bashkohen kremtimit të Eukaristisë. Pra përshpirtëria mariane shprehet në kultin liturgjik dhe atë devocional. Mënyra klasike e lutjes në liturgji i drejtohet gjithmonë Hyjit trinitar dhe një gjë është e qartë se lutjet liturgjike nuk i drejtohen Marisë. Por në atë miqësinë e Hyjit me shenjtërit, ata bashkohen me lutjen e Kishës tokësore e kjo e përforcon faktin se Maria afër shenjtërve tjerë ka një vend e ky vend merr një rëndësi më të madhe kur arrihet vetëdija e ndërgjegjësuar për funksionin e saj në misterin e Krishtit. Pasi që liturgjia ndjek besnikërisht rregullën biblike, sipas së cilës lutja duhet t'i drejtohet Atit nëpërmjet Krishtit, në Shpirtin Shenjt (krh. Ef 2,18), kulti marian vihet në adhurim të Trinisë Shenjte.

U tha më sipër se përshpirtëria mariane përveç kultit liturgjik shprehet edhe në aspektin devocional. Një ndër shprehjet devocionale të kësaj përshpirtërie është edhe muaji i majit.

Muaji i majit. Fillimet dhe strukturimi

Muaji i majit, nuk figuron në kalendarin liturgjik, megjithatë ka ndodhur që në disa epoka devocionet e ndryshme kanë krijuar një farë cikli kultural mujor përtej liturgjisë, duke u përqendruar rreth një feste të shënuar në kalendar (muaji kushtuar Zemrës së Krishtit, Gjakut të Krishtit, të

vdekurve). Edhe devocioni marian ka zhvilluar këtë përkushtim mujor.

Nderimi i Nënës së Zotit, në mënyrë të veçantë çdo ditë të një muaji, motivohet nga frymëzime të ndryshme: nga liturgjia në Lindje e nga devocioni në Perëndim. Kjo gjë ka përcaktuar aspektin kultural të muajit marian shprehur në veprime liturgjike ose në përshpirtëri popullore. Në lindje kjo praktikë lind nga një kremtim i rëndësishëm liturgjik që ka nxitur dhe përqendruar rreth vetes edhe lutjen e ditëve tjera të muajit. Bëhet fjalë për të kremten e të ngjiturit të Virgjërës Mari në qiell (Dormizione) në muajin e gushtit për Kishën Bizantine.

Ndërsa muaji i majit, në Perëndim, nuk është i lidhur me ndonjë kremtim liturgjik, por ka fillimet e tij në Itali në periudhën iluministe, në shekujt XVII-XVIII, si alternativë e festave pranverore, karakterizuar nga grumbullime, këngë, homazhe me lule. Në këtë kontekst, si sforcim i inkulturimit popullor, lind praktikimi i muajit maj në nder të Marisë Virgjër. Autorë të kësaj iniciative janë disa jezuitë në krahina të ndryshme të Italisë të cilët i japin muajit maj një orientim shpirtëror duke medituar të vërtetat e mëdha të fesë e virtytet e krishtera me bindjen se devocioni ndaj Marisë Virgjër i bën të krishterët më besnikë. Muaji marian zhvillohet sipas një programi kateketik e formativ me synim të qartë: rigjallërimi i jetës shpirtërore të besimtarëve, familjeve, grupeve e bashkësive famullitare. Pra, në Kishën e Lindjes muaji marian ka karakter liturgjik, ndërsa në Perëndim jo domosdoshmërisht. Duke pasë parasysh që Kisha lindore paraqet një stabilitet në rregullimin liturgjik, nderimi mujor ndaj Virgjërës Mari nuk ka pësuar ndonjë krizë. Ndryshe ndodh në Kishën perëndimore, lidhja me devocionet ka pësuar ndryshime. Reforma liturgjike e Koncilit të dytë të Vatikanit, ka ndikuar shumë edhe në përshpirtërinë popullore, por gjithashtu edhe në muajin marian duke ofruar dy orientime: rinovimin cilësor të përmbajtjes së përshpirtërisë praktike duke e dalluar nga liturgjia; dhe duke kërkuar një farë sintonie me kohën pashkvore me të cilën koinçidon. Pasiguria që paraqet impakti me reformën ripërtëritëse të Vatikanit të dytë, ka krijuar sipas vendeve, situata të ndryshme: braktisje të muajit marian tradicional (përveç përmbajtjeve që janë konsideruar të papërshtatshme, ka ndikuar edhe ndryshimi shoqëror, kalimi nga sistemi bujqësor i jetës në atë industrial, shekullarizimi); gjithashtu edhe reflektimi mbi muajin marian në dritën e mariologjisë së *Lumen gentium* dhe të parimeve që rregullojnë raportin ndërmjet liturgjisë dhe praktikave devocionale (krh. SC 13).



Trashëgimia dhe rinovimi

Pra, sikurse u tha më sipër, rinovimi liturgjik ka ndikuar edhe në përshpirtërinë popullore e sigurisht edhe në atë mariane. Kjo gjë na nxit të angazhohemi që të nderojmë emrin e Marisë, duke mësuar nga ajo modelin e fesë dhe të përgjigjes së saj ndaj çdo ftese të Hyjit, të mësojmë nga ajo si të përvetësojmë mësimin e Krishtit dhe dashurinë e tij, derisa të gjithë besimtarët të bashkuar me Nënë e përbashkët të ndihën gjithnjë më të fortë në fe dhe në dashuri vëllazërore. Kjo mënyrë hap rrugën për një devocion të ripërtërirë ndaj Marisë dhe zgjeron kufijtë e veprimit në jetën e përditshme.

Ky devocion na ndihmon që si besimtarë të përjetojmë me Marinë dhe si Maria pjesëmarrjen në misteret e Krishtit që përjetojmë në Eukaristinë e shenjtë (MC 48). Asambleja liturgjike në lutjen e saj rijeton lutjen e Marisë, duke këshilluar bashkimin, imiton qëndrimin e brendshëm të saj që është hapje ekzistenciale ndaj Hyjit e ndaj të afërmit. Me Marinë dhe si ajo, Kisha beson, shpreson, do, kremton dhe jeton misterin e Krishtit, duke udhëtuar drejt pjesëmarrjes së plotë në Mbretërinë e Qiellit, parashikim i së cilës është liturgjia. Shën Pali i VI ka theksuar në *Marialis cultus* se: “*Virgjra Mari është propozuar gjithmonë nga Kisha për t’u imituar nga besimtarët, jo për mënyrën e jetës që ajo ka bërë, as për ambientin social-kulturor në të cilin jetoi, që sot pak a shumë është tejkaluar gati në të gjithë botën; por sepse në gjendjen konkrete të jetës së saj, ajo pranoi totalisht e në mënyrë plotësisht të përgjegjshme vullnetin e Zotit (krh. Lk 1,38); sepse e pranoi fjalën dhe e aktualizoi, e vuri në praktikë; sepse veprimi i saj që mbështetur nga dashuria dhe nga shpirti i shërbimit; sepse që e para e më e përkryera ndjekëse e Krishtit: e cila ka një vlerë shembullore, universale dhe të përhershme*” (MC 35).

Përshpirtëria mariane është një trashëgimi e Traditës së Kishës dhe e Koncilit të dytë të Vatikanit dhe sikurse ndodh me çdo trashëgimi, mund të refuzohet, mund të shpërdorohet, mund të bëhet objekt konfliktesh e debatesh, ose mund të bëhet mjet fortifikimi e pasurimi. Mënyra më e mirë për të qenë trashëgimtarë të mirë të Vatikanit të dytë e për ta bërë atë “busull orientuese për të tashmen dhe të ardhmen e Kishës” është: të mësojmë “të mendojmë së bashku me Koncilin e dytë të

Vatikanit”. Kjo mënyrë kërkon që parimet e Koncilit mos reduktohen në një përmbledhje konceptesh që duhet të ruhen e të përsëriten, por të konsiderohen si një mënyrë origjinale reflektimi e qëndrimi themelor, “një mënyrë për të kuptuar pikëpyetjet e epokës sonë dhe një metodë për t’i menduar ato në fe”.

Sigurisht se kjo temë nuk mund të trajtohet në plotësi në këtë artikull, por mund të themi se përshpirtëria mariane është karakteristikë e përshpirtërisë popullore dhe se teologjia duhet të mësojë nga përshpirtëria popullore. Kjo e fundit duhet të ungjillëzohet, të udhëhiqet dhe të orientohet, por vetëm në atë masë në të cilën është në gjendje të lejojë të ungjillëzohet prej saj. Nuk duhet të mbyllen sytë përballë rreziqeve e shtrembërimeve të përshpirtërisë popullore, por nuk duhet as të vlerësohet duke u nisur nga rreziqet. Njerëzit e thjeshtë dhe të varfrit kanë shumë për të na mësuar, thotë Papa Françesku, e ne duhet të dimë të pranojmë urtinë që Hyji dëshiron të na komunikojë nëpërmjet tyre. Përshpirtëria popullore transmeton imazhin e një Hyji që është afër kulturës së një populli; kjo shprehje e fesë së inkulturuar nuk është thjeshtë një akt njerëzor, por është shprehje e hirit, sepse “hiri, dhurata e Hyjit mishërohet në kulturën e atij që e pranon, sepse feja si çdo akt tjetër i lirë, jetohet në një ambient historik e kulturor konkret. Përshpirtëria mariane shpreh në mënyrë të plotë këtë kujdes në aspektin kulturor. Ajo na mëson se feja e krishterë nuk është e lidhur vetëm me një kulturë ose vetëm me një ambient, por në mënyra të ndryshme e në kontekste të ndryshme të cilat kanë nevojë të merren në konsideratë të studiohen e të ungjillëzohen.

Motër Dila Shtjefni



Moter Marjeta Gjoka

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

ZEMRA E JEZUSIT E DHURUAR PËR NJERËZIMIN

Është Ungjilli i Shën Gjonit që na jep portretin më besnik të kësaj zemre, gjithashtu në këtë ungjill shfaqet edhe shqetësimi i Atit më dominues. Vazhdimësia e leximit të ungjillit i bën të ndjejë njeriut se Jezusi jeton në dashurinë e Atit. Është dashuria Atërore që përbën të gjithë bazen e aventurës tokësore të mishërimit të Jezusit, dhe kjo dashuri është qendra e reflektimeve dhe veprimeve të Tij. Jezusi erdhi në botë i dërguar nga Ati dhe për lavdinë e Tij, çdo gjë që ai bën mësimet, mrekullitë është falë Atit. Siç na e thotë edhe tek ungjilli i Shën Gjonit, «sikurse mua më dërgoi Ati i gjallë dhe unë jetoj për Atin, po ashtu edhe ai që ha mua do të jetojë për mua» (Gjn 6, 57) me këto fjalë Jezusi na lë të kuptojmë sekretin e jetës së tij. Ati është qëllimi i ekzistencës së Tij tokësore dhe e ka të qartë misionin që është mision dashurie. Jezusi është bërë njeri falë jetës që i është dhuruar nga Ati, vjen nga Ati dhe duhet të shkojë drejt Atit. Ai është Udhë që na dërgon te Ati e na bashkon me të. Të flasim për dhurimin që Jezusi bën ndaj njerëzimit nuk mund ta shkëpusim nga një mardhënie e ngushtë me Atin.

Zemra e Krishtit model dashurie

Kur një skrib ose një farise e pyet Jezusin se cili është urdhërimi kryesor, Mësuesi u përgjigjet: «*Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd e me gjithë mendjen tënde!* Ky është më i madhi dhe i pari urdhërim. I dyti është i barabartë me të, *Duaje të afërmin tënd porsì vetveten!*». Në këtë mënyrë Ai deklaroi se ka një ekuivalencë mes këtyre dy dashurive. Është një lidhje reciproke që u jep atyre një rëndësi të barabartë, pra që i bën ata «të ngjashëm». Ju nuk mund ta doni Zotin nëse nuk e doni të afërmin tuaj, as nuk mund ta doni të afërmin nëse nuk e doni Zotin. Në këtë përgjigje, Jezusi zbulon kuptimin e jetës së tij, pasi Ai i kishte përmbushur këto urdhërime përpara se t'i shpallte ato. Pa harruar që Jezusi në zemrën e tij ka një dashuri të madhe për njerëzit «e ngjashme» me dashurinë e Atit. Këto dy dashuri identifikohen te Ai në atë mënyrë që shfaq dashurinë e tij për Atin, në të njëjten mënyrë konsiston përkushtimi dhe dashuria që ka ndaj njerëzimit. Për shpëtimin e njerëzimit Biri pranoi misionin që Ati i kishte caktuar. Për njerëzimin ai e la shtëpinë e Atit dhe erdhi në botë, anasjelltas la botën për t'u kthyer te Ati. Në fakt, Fjala nuk do të kishte nevojë të zbriste në tokë për ta dashur Atin dhe për ta dashur atë plotësisht. Ai mund të kishte mbetur në intimitetin qiellor dhe të vazhdonte me qetësi dialogun e tij të pandërprerë të dashurisë. Por kishte njerëz që ai vetë i kishte krijuar dhe ndaj të cilëve nuk ishte indiferent, ishte njerëzimi që e tërhoqën këtu poshtë. Fjala u bë njeri për shkak të njerëzve. Dashuria për njerëzit e bëri atë të merrte një zemër



njerëzore, para se të ishte burim dashurie kjo zemër ishte e krijuar nga vetë Dashuria.

Zemra e Krishtit e krijuar nga vetë Hyji që t'i përkasë njerëzimit, u edukua nën hijen e Nazaretit për ndjenjat njerëzore dhe veprimet e dashurisë. Ne nuk dimë asgjë për këtë edukim përveç rezultateve, në jetën publike Jezusi shfaq dashurinë për njerëzit ndaj të cilëve u formua gjatë jetës së tij të fshehtë. Në aludimet e shkurtra të Ungjillit është e vështirë të gesh gjithë pasurinë e kësaj dashurie, pasi manifestimet e dashurisë janë kapur mbi të gjitha në kontaktet e drejtpërdrejta person-me-person, në të cilat hyjnë faktorë të papërfillshëm, të cilët nuk mund të përkthehen drejtpërdrejt nga historia e shkruar. Megjithatë, do të përpiqem të nxjerri në pah disa prej tyre, të cilët drejtuan jetën e Krishtit në detajet e veprimeve dhe fjalëve që Ai tha. E gjithë mënyra e të vepruarit e Jezusit është frymëzuar nga lidhja e tij me njerëzimin, që nga pagëzimi dhe qëndrimi në shkretëtirë deri te vdekja dhe ringjallja e tij. Nëse është e vërtetë se të gjitha veprimet, sjelljet, qëndrimet, mendimet dhe ndjenjat e Jezusit e gjejnë burimin e tyre në dashurinë e Atit, është gjithashtu e vërtetë se ato mund të gjejnë një shpjegim në dashurinë për njerëzit.



Edhe disa episode në të cilat kjo dashuri nuk duket menjëherë janë të frymëzuara prej saj. Kur Jezusi pagëzohet nga pararendësi, sigurisht që nuk është për veten e tij, pasi ai gëzon pastërti morale absolute dhe nuk ka nevojë për asnjë rrëfim apo pendim, përkundrazi ai e bën atë për njerëzit. Ai e lë veten të afrohet dhe të tundohet nga djalli në shkretëtirë, pasi e gjithë vuajtja është për shpëtimi e njerëzimit. Gjithashtu e len veten të shihet në lavdinë e shëndërrimit nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni, ai dëshiron të mbështesë guximin e tyre, përpara sprovës tashmë të afërt të pasioneve dhe mundimeve. Maturia e paraqitjeve të tij pas ringjalljes na tregon se ai donte që ky triumf të mos mashtrohet, por të komunikonte gëzimin dhe jetën e tij të re. Edhe ngjitja në lavdi, kthimi përfundimtar në shoqërinë e Atit, ka si qëllim dashurinë për njerëzit, siç u deklaroi shprehimisht dishepujve, Jezusi ngjitet në qiell për të përgatitur vendin e tyre.

Duke rizbuluar frymëzimin e dashurisë në ngjarjet e jetës së Jezusit dhe duke kapur emocionin në veprimet dhe fjalët e tij karakteristike, ne do të arrijmë qëllimin e Ungjillit dhe të Zbulesës. Në fakt, Krishti erdhi në këtë tokë për të na treguar dashurinë që ka për ne. Si çdo provë tjetër dashurie dëshiron të zbulohet nga ata të cilëve u drejtohet kjo dashuri. Ajo mbetet pothuajse e mbuluar nga një vello, nëse do të ishte shumë e dukshme do të bëhej një shfaqje e respektit për veten dhe do të mbyste liritë në vend që t'i zhvillonte ato, do t'i ngjeshte shpirtat në vend që t'i tërheqë ato.

Prandaj, dashurin e Jezusit duhet ta lejojmë që të depërtojë në ne, kjo dashuri merr përmasat e pafundme që zotëron në të vërtetë dhe zbulon thellësi të habitshme nën një pamje shpesh të zakonshme.

Bariu i përsosur

Që të kuptojmë dashurinë e Jezusit për njerëzit, shën Gjoni mori alegorinë e Bariut të mirë nga mësimi i Mësuesit. Në një nga fjalimet e tij Jezusi përshkruan figurën e Bariut të mirë, domethënë një Bari i përsosur, *(pikërisht edhe sipas termit grek që përdoret, "i mirë" nuk do të thotë mirësi dhe butësi zemre, por përsosmëri e cilësive të bariut, me nuancën e njëfarë natyraliteti apo elegance në këtë përsosmëri* (krh. Gjn 10,11). Me artin e thjeshtë dhe real të dikujt që i ka vëzhguar gjërat dhe njerëzit dhe i ka kapur direkt. Jezusi përshkruan sjelljen e Bariut ndaj grigjës së tij, mënyrën e njohur për t'i thirrur për emër, për t'i nxjerrë jashtë vathës, për të ecur përpara tyre në rrugë. Për të nxjerrë në pah bukurinë dhe mirësinë e sjelljes së tij, ai e kundërshton atë me qëndrimin e vjedhësit. Vjedhësit nuk hyjnë në vathë nga dera dhe përpiqen të marrin në zotërim delet për t'i therur dhe për ti mbytur, ndërsa Bariu i mirë bën gjithçka për t'i bërë të gjalla, për t'i majmur e për t'i lulëzuar, ai dëshiron vetëm që ato të jetojnë. Prandaj, delet refuzojnë të ndjekin vjedhësin, zëri i çuditshëm i të cilëve i bën mosbesuese ndërsa në vend të kësaj i binden me besim zërit të Bariut që i

drejton drejt kullotave të pasura. Ndërsa mercenarët, duke mos qenë pronarë të kopesë, nuk janë të lidhur me të dhe veprojnë vetëm për interes. Në momente rreziku, kontrasti është shumë i dukshëm, mercenari ikën nga ujku, ndërsa Bariu i vërtetë nëse është e nevojshme jep jetën për delet e tij. Është e sigurt se dishepujt janë të magjepsur nga ky përshkrim i freskët dhe i gjallë i bërë nga vetë Jezusi. Në përgjithësi, Jezusi fillon duke treguar një histori dhe më pas pret të pyetet nga dëgjuesit për mësimin që do të nxirret nga Ai. Këtë herë ai përgjigjet duke dhënë përkufizimin më të bukur për veten, «Unë jam Bariu i mirë». Nga shëmbëlltyra ai kalon në mister. Jezusi krahason veten me një bari, nuk e lartëson veten në sytë e dishepujve dhe me këtë krahasim ai u hap atyre thellësitë e zemrës.

Bariu është ai që i thërret delet për emër

Bariu i mirë është mbi të gjitha ai që i njeh delet e tij, të gjitha i quan për emër, është një detaj që duket i parëndësishëm, por që zbulon një mentalitet të tërë. Për kalimtarët dhe të huajt, kopeja është një tufë dhe të gjitha delet janë të barabarta dhe të njëjta. Por, për bariun secila prej tyre dallohet nga të tjerat, ka fizionominë e vet dhe mban një emër. Bariu i njeh delet në mënyrë të përsosur, sepse i do dhe ka një interes të veçantë për secilën prej tyre. Sa dashuri di të vë në emrin me të cilin i thërret një nga një! Herën e parë që Jezusi takon Pjetrin, i thotë: «Ti je Simoni, biri i Gjoni» (Gjn 1, 42). Ky emër i Simonit do të kthehet në buzët e Hyjit me intonacione të ndryshme duke shprehur nuanca të ndryshme miqësore. Përsëri Pjetrin e pyet, «Simon, çka të thotë mendja, mbretërit e dheut, prej kujt e mbledhin taksën ose tatimin? Prej fëmijëve të vet apo prej të huajve» (Mt 17, 25). Ngrohtësia e Jezusit vazhdon duke u shprehur kështu «i lumi ti, o Simon, biri i Jonës, sepse këtë nuk ta zbuloi mishi e gjaku, por Ati im që është në qiell!» (Mt16, 17). Por njëkosisht na manifestohet edhe premtimi solemn i ndihmës së Tij, «Simon, Simon, ja, Satani kërkoi t'ju shoshë porsi grurin! Por unë u luta për ty, që feja jote të mos mungojë....» (Lk 22, 31-32). Këtu ndiejmë se Jezusi, duke e përsëritur dy herë emrin e udhëheqësit të dishepujve, dëshiron ta lidhë më fort me veten dhe ta pengojë që të dekurajohet ngaqë e ka mohuar. Pastaj vjen një qortim disi i përzemërt, «Simon, a po fle?» (Mk14, 37), dhe lutja e një deklarate të trefishtë dashurie, «Simon Gjoni, a më do ti më shumë se këta? Po, Zotëri - iu përgjigj - Ti e di se të dua! Kulloti qengjat e mi! - i tha Jezusi. Prapë e pyeti të dytën herë: Simon Gjoni, a më do ti mua? Po, Zotëri, ti e di se të dua! - iu përgjigj Pjetri. Kulloti delet e mia! - vijoi Jezusi» (Gjn 21, 15-17)

Siç vihet re duke shqiptuar emrin e Simonit, Bariu i mirë zbuloi lëvizje të shumta të dashurisë së tij, Ai sigurisht nuk e thirri me emër kaq shumë herë rastësisht më të madhin e dishepujve të tij. Megjithatë, atij i pëlqen t'i thërrasë edhe njerëzit e tjerë me emër. Ai përpigjet t'i bëjë Filipit të kuptojë vlerën e një afërmiteti



që nuk vlerësohet sa duhet, «O Filip - i tha Jezusi - kaq shumë kohë jam me ju e nuk më njohe ende?» (Gjn 14, 9). Në këtë emër të shqiptuar, Jezusi dëshiron të përmbledhë gjithë ofertën e zemrës së tij. Lutja e fundit që i bën tradhtarit e thirr për emër, «O Judë, a me të puthur po e tradhton Birin e njeriut?» (Lk 22, 48). Ndërsa në Betani ai i përgjigjet shqetësimeve të Martës, «Martë, Martë - iu përgjigj Zotëria - ti po brengosesh dhe po shqetësohesh për shumë gjëra». Ai e përsërit emrin e saj për ta bërë që të reflektoj.

Edhe të vdekurit i thërret për emer, «Lazër, dil jashtë» (Gjn 11, 43). Jezusi i drejtohet mikut të tij të vjetër me të njëjtën njohje me të cilën e trajtoi kur ishte mysafir në shtëpinë e tij dhe ky emër i thirrur nga Jezusi e kthen në jetë Lazërin, me pak fjalë zëri i Bariut të mirë kumbon edhe në jetën e përtejme. Është zëri i një të ringjalluri që, pasi e pyeti Magdalenën në një formë jopersonale, «Pse po qan, moj fisnike?», pastaj e thërret me emër, «Mari» (krh. Gjn 20, 15-16). Kjo fjalë ka një efekt magjik, duke rilidhur një afërmitet të ndërprerë në një mënyrë tragjike. Maria Magdalenë nuk e harroi kurrë tonin e zërit me të cilin shqiptoi emrin e saj, por ajo tashmë e njeh Jezusin edhe gjithë mirësinë e tij ndaj saj. Më vonë një zë i njëjtë do të kumbojë rrugës për në Damask, «Saul, Saul, pse po më salvon?» (Vap 9, 4). Edhe persekutuesi thirret me emër. Pasi e verboi me dritën e tij dhe e hodhi në tokë. Ky emër «Saul» i përsëritur do të mbetet i gdhendur në kujtesën e Apostullit si shenjë e parapëlqimit të Krishtit.

Nga këta shembuj kuptojmë se sa fuqi dashurie i dha Bariut i mirë emrit me të cilin i thirri delet e tij dhe çfarë transformimi shkaktoi në to, te Lazri kalimi nga vdekja në jetë, te Maria Magdalenë ndryshimi nga trishtimi në një shpërthim gëzimi dhe mirënjohjeje, shndërrimi i një Sauli përndjekës në apostullin Pal. Ndonjëherë Jezusi i kushton këta transformime duke vendosur një emër të ri, siç bëri me dishepujt e tij të zgjedhur, Pjetrin, Jakobin, Gjonin, të cilëve u dha një emër në lidhje me misionin e tyre të ardhshëm.

Jezusi, ai i cili i njeh zemrat

Njohja e emrit është vetëm një simbol. Ajo që Jezusi di në të vërtetë për njerëzit është personaliteti i tyre dhe ndjenjat e tyre më të thella. Duke udhëtuar nëpër rrugët e Palestinës, ndërsa të tjerët hedhin një vështrim indiferent ose thjesht kureshtar mbi kalimtarët dhe udhëtarët, Hyji zbulon menjëherë në fytyrë se ai takohet me historinë e jetës dhe me prirjet intime të shpirtit të tij. Sytë e njerëzve nuk mund t'i fshehin asgjë nga mendimet e tyre, dhe në tiparet e fizionomisë ai njeh menjëherë shprehjen e prirjeve dhe aspiratave më të thella. Vështrimi i tij depërton në misterin e zemrave. Jezusi tashmë i njeh dishepujt e tij që nga hera e parë që i thirri, «Ja një izraelit i vërtetë në të cilin nuk ka dredhi! Nga më njeh? - i tha Natanaeli. Jezusi iu përgjigj: Para se të të thërriste Filipi, të pashë nën fik!» (Gjn 1, 47-48). Ai i ka njohur gjithmonë ata që ka zgjedhur, e njeh karakterin e tyre, madje edhe detajet

më të parëndësishme të jetës së tyre, siç është i të qenurit nën fik. Po ashtu edhe gruaja samaritane e përjetoi këtë njohuri. Ajo kishte besuar se mund të mbronte respektin për veten dhe të ruhej midis saj dhe atij hebriu. Por Jezusi e shtyn atë në shpalosjet më të thella të shpirtit të saj, duke zbuluar gjendjen e saj të vërtetë morale me një fjalë të vetme. «Zotëri - vijoi gruaja - po shoh se je profet» (Gjn 4, 19) përgjigjet gruaja, e cila e sheh veten krejtësisht të zbuluar. Sa herë tregon Jezusi se i njeh reagimet më të fshehta të dëgjuesve të tij, dishepujve dhe farisenjve! Nuk është e nevojshme që kundërshtarët e tij t'i shprehin mendimet e tyre me fjalë. Jezusi thotë Ungjilli, u përgjigjet atyre dhe jo fjalëve, por zemrave. Për shembull, farisenjve të cilët murmuritin brenda vetes sepse Jezusi i ka falur mëkatet të paralizuarit, ai u përgjigjet, «Çka po mendoni në zemrat tuaja?» (Lk 5, 22). Kur Simoni fariseu i cili e ftoi në tryezën e tij, mendon se një profet do ta kishte njohur një mëkatar, që ishte ajo grua që kishte ardhur për t'u hedhur në këmbët e tij, Jezusi i përgjigjet, «Simon, dua të të them diçka» (Lk 7, 40). Pasi dishepujt u grindën mes tyre gjatë rrugës për të kuptuar se kush ishte më i madhi mes tyre, sa mbërriti në Kafarnaum Jezusi i pyet ata, «mbi çka biseduat rrugës?». Dishepujt heshtin, dhe më pas ai vendos para syve shembullin e një fëmije për të zgjidhur çështjen që ata kanë ngritur. Asgjë nuk i shpëton finesës së perceptimit të tij, në mes të një turme që e rrethon dhe e shtyn nga kudo, ai e di se një grua e ka prekur me një besim të madh.

Edhe Juda do të përpiqet më kot të fshehë qëllimet e tij, Jezusi do të ndjekë hap pas hapi zhvillimin e fajit në zemrën e dishepullit dhe do të shumëfishojë paralajmërimet. «Njëri prej jush është djall!» (Gjn 6, 71), «përnjëmend, përnjëmend po ju them: njëri prej jush do të më tradhtojë» (Gjn 13, 21). Hipokrizia nuk është në gjendje të fshehë errësirën e vet në dritën e shikimit të tij.

Kjo njohuri që ka për njerëzit i lejon Krishtit të trajtojë çdo person në mënyrë të përshtatshme. Dy dishepujve të parë, të cilët, duke mos guxuar ende të angazhohen shumë, e pyesin se ku jeton, ai u përgjigjet, «Ejani e shihni» (Gjn 1, 39), duke i lejuar ata të vëzhgojnë dhe të reflektojnë përpara se të lidhen përfundimisht me të. Ndërsa thirrja e Levit është menjëherë vendimtare, «Eja pas meje» (Mt 9, 9). Siç vërehet Jezusi kur thërret dikë i kërkon braktisjen e mënjëhershme të atyre gjërave që don më shumë dhe që i ka si pasuri vetjake, ato pasuri që e lidhin të krishterët duke mos e lënë të lire që të ndjekë Rrugën e Vërtetë dhe Jetën që është vetë Krishti. Edhe pse thirr ai nuk detyron por kush dëshiron që me liri ta ndjek Ai e udhëzon se çfarë duhet bërë për të shkuar pas Tij. Udhëzon me shembullin konkret të jetës së Tij duke dhuruar krejt vetvetën për të fituar mbarë njerëzimin, kjo është Zemra e vërtetë e Jezusit!



Dom Lush GJERGJI

**PAPA GJONI XXIII DHE KONCILI I DYTË I VATIKANIT
(1881 – 1963)**

(60 – vjetori i vdekjes: 3 korrik 1963 – 3 korrik 2023)

Por ju duajini armiqtë tuaj, bëni mirë e huazoni pa pritur se do t'ju kthejnë gjë. Kështu do të jetë i madh shpërblimi juaj dhe do të jeni bijtë e të Tejetlartit Zot, sepse ai ua do të mirën edhe mosmirënjohësve e të këqijve.“

(Lk 6, 35)

„Të duhemi mes veti, të kemi kujdes ndaj njëri-tjetrit në takime, që të mund të pranojmë atë që na bashkon, kështu duke shmangur atë që mund të na largojë. Me të kthyer në shtëpi përkëdhelni fëmijët tuaj dhe tëhuaquni se kjo përkëdhelje është e Papës... Fëmijëz, nuk duhet të mendohet më në të kaluarën. Hyji e din mirë atë që ndodhi, gjithë atë duhet besuar mëshirës së tij, mirësisë së tij të pafund. E juaja është vetëm e tashmja... Duhet mbrojtur shpirtin e paqes... Besoj se Zoti do t'iu përgjigjet shpresave dhe pritjeve të botës e cila ka dëshirë aq të madhe për paqe...“.

Shën Gjoni XXIII



Të shkruhet apo flitet, sot, për papën Shën Gjonin XXIII, apo siç e quanin të gjithë *“Gjoni i Mirë”*, është shumë vështirë, mirëpo njëkohësisht edhe e nevojshme, e dobishme, e domosdoshme, sepse ky margaritar i Kishës dhe njerëzimit të shekullit njëzet nuk guxon të harrohet, si dhe kujtimi në te nuk guxon të humbet. Me të erdhi rrezja e dritës dhe diellit, shpresës, mirësisë, dashurisë dhe vëllazërisë, hapja e Kishës ndaj gjithë botës.

Jeta e tij qe e gjatë, 82 vite, pontifikati i tij i shkurtër, vetëm 5 vite, porosia e tij e amshueshme, personaliteti i tij karizmatik, gjithnjë i gjallë në Kishë dhe botë. Kështu që duke përkujtuar atë do të thotë ta ringjallësh atë, të shkruash për të do të thotë t'ia ofrosh atë gjeneratave të reja, sepse siç dihet, dashuria nuk vdes kurrë.

Angelo Giuseppe Roncalli, papa Shën Gjoni

XXIII, u lind në Sotto il Monte, fshat afër Bergamo-s, më 25 nëntor 1881 në një familje fshatare me shumë fëmijë si dhe varfëri të theksuar. Pikërisht aty, në rrethin familjar, mësoi artin e dashurisë, fesë, lutjes, flijimit, komunikimit me të tjerët, solidaritetin.

Prejardhje e varfër dhe e thjeshtë, mbetën karakteristika themelore të jetës së tij. Në shkollë ishte i mirë, kështu që famullitarii këshilloi prindërit e tij që t'ia mundësojnë vazhdimin e mëtutjeshëm të shkollimit.

Hyri në seminar. Mirëpo edhe aty duhej të paguante, e para nuk kishte. I ati i tij Giovanni Battista dhe nëna Maria njëherë i thanë: *„Je fëmijë i fshatarëve skamnorë. Edhe nëse arrin të bëhesh meshtar, do të jesh gjithmonë meshtar i varfër...“*

Mirëpo, për shkollimin e tij u kujdes Provania hyjnore. Një monsinjor mori për sipër kujdesin për



pagesë të seminarit. Në mësim ishte i zellshëm, kurse në jetën e përshpirtërisë shumë i dalluar, me të tjerët i shoqërueshëm dhe i lumtur, gjithmonë i gëzueshëm.

I riu Angelo Giuseppe Roncalli kreu studimet filozofiko-teologjike në Begamo. Studimet posdiplomike i vazhdoi në Romë. Shërbimin ushtarak e kreu për 12 muaj. Që shuguruar për meshtar në Romë me 10 gusht 1904, kurse Meshë e Parë kremtoi në vendlindje me 15 gusht 1904.

Ja dëshmia e tij rreth meshtarisë: „Zoti dëshiron të bëhem meshtar; për këtë më shpërbleu me mirësitë e tij, aq sa më dërgoi në Romë nën përkrahjen e Papës, zëvendësit të Jezu Krishtit, në Qytetin e Shenjtë, afër varrezave të shumë martirëve, shumë meshtarëve të shenjtë... Nuk u bëra meshtar për të qenë i nderuar, ose shakë i përfitimit, për të jetuar më lehtë, për të jetuar e shijuar nderin dhe kënaqësinë. Runa Zot, vaj për mua po të ishte kështu! Por para së gjithash dhe vetëm për këtë u bëra meshtar, t'i bëj mirë në të gjitha mënyrat botës skamnore.“

Ishte vite të tëra sekretar i ipeshkvit të Bergamos mons. Radini-Tedeschia-s, e më pas shpirtërore teologjinëe Bergamos.

„Themeli i apostolatit tim është jeta ime e brendshme. Do i dua të rinjtë sikur një nënë e mirë“ shkruante kështu don Angelo Roncalli.

Në vitin 1921 ishte i ftuar në Romë në Kongregatën Propaganda Fide, sot Kongregata për Ungjillëzimin e popujve, për kryetar të Zyrës për përhapjen e fesë për Itali.

Nga Roma shkruan: „Me zemër të thyer kam lëshuar Bergamon, atë që e desha: seminarin, shtëpinë studentore...Ndihëm i hedhur me tërë shpirtin tim në shërbim të ri. Këtu dëshiroj dhe duhet të rri pa mëdyshje, pa shikuar apo dashur ndonjë gjë tjetër.“

Në vitin 1925, emërohet argjipeshkëv dhe vizitator apostolik në Bullgari, shugurohet më 19 mars po të njëjtin vit. Mons. Angelo Roncalli shkruan: „Në realitet të jesh i emëruar ipeshkëv apo të mbetesh meshtar i rëndomtë, nuk do të thotë shumë për atë shpirt icili kërkon lavdinë e Hyjit, e jo shkëlqimin e rrejshëm të kënaqësive të kësaj bote... Jam i dëgjueshëm dhe me këtë aftësohem për t'i braktisur disa gjëra dhe për t'i pranuar tjerat“.

Dhjetë vite në Bullgari

Menjëherë pas shugurimit ipeshkëvor, ai shkoi në Bullgari (25 prill 1925), ku qëndroi plotë dhjetë vite. Në meshën e parë publike tha këtë: „Thjesht do të tregoj mënyrën e trajtimit të cilën do duhej në të ardhmen të kanë katolikët bullgarë ndaj ortodoksëve: këta janë vëllezërit e juaj. Nuk mjafton vetëm të kesh ndaj tyre ndjenja të përzemërta. Nëse i doni vërtet, ju jepni shembull të mirë përmes dashurisë suaj në

vepër!“.

Që të dëshmoj këtë dashuri në vepër, ai menjëherë filloi t'i vizitojë bashkësitë e vogla katolike në Bullgari në kufi me Greqinë dhe Turqinë. Pas vizitave tha para gazetarëve bullgarë: „Erdha këtu që t'iu sjell katolikëve bullgarë bekimin e Atit të Shenjtë, i cili gjithnjë ka nderim të thellë dhe dashuri të përzemërt ndaj popullit bujar bullgar...Pashë një pjesë të mirë të vendit tuaj. Isha i pushtuar me thjeshtësinë dhe mirësinë e popullit i cili na pranoi gjithkund me mirëpritje prekëse... Isha dëshmitar i tolerancës së plotë të popullit bullgar ndaj pakicave fetare dhe kombëtare.“

Mons. Angelo Roncalli në mënyrë të shkëlqyeshme kreu misionin e tij apostolik në Bullgari duke animuar, mbështetur dhe inkurajuar bashkësitë katolike që të jenë të bashkuara, të vetëdijshme për rolin të cilin e kanë në mesin ortodoks.

Delegat Apostolik në Turqi dhenë Greqi

Por, ja sfida e re, prapë edhe njëndërrim. Më nuk është i ri, tanimë është 53 vjeçar. Në vitin 1934 qe emëruar delegat apostolik në Turqi dhe Greqi.

Në predikimin e tij përshëndetës, tha: „Pas dhjetë vitesh në Bullgari, ajo më është bërë e dashur...Kudo të jam, po edhe në skaj të botës, kur do të kaloj ndonjë bullgar pranë shtëpisë sime, do ta gjej në dritare qirium e ndezur. Do trokasë në derën time dhe ajo do t'i hapet, pavarësisht është ai katolik apo ortodoks. Vëlla Bullgar: mjafton vetëm ky titull për të hyrë brenda e të gjej vërtet mirëpritje shumë të përzemërt në shtëpinë time...“

Turqia atëherë ishte në pozitë shumë të vështirë. Mustafa Kemal-pasha Ataturk (1881- 1938) krijoi Republikën Turke laike (1922), me kryeqytetin e Ankarasë. Ai dëshiroi ta europianizonte Turqinë, duke ndërruar Kushtetutën, sipas shembullit të ligjeve italiane dhe zvicerane. Futi në përdorim alfabetin latin, kalendarin europian, shpalli të dielën ditë pushim dhe ditë feste në vend të premtës, ndërpreu poligaminë dhe shpalli Turqinë shtet laik, me të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë qytetarët e saj.

Gjitha këto ndryshime, i sollën popullatës turke vështirësi të shumta. Pas takimit të parë me këtë realitet mons. Roncalli shkruan: “Ndoshta do kam ditë të rënda e situata të vështira... Mirëpo, unë vazhdimisht shikoj në lartësi dhe në largësi...”

Në Turqi mori lajmin mbi sëmundjen, më pas edhe mbi vdekjen e të atit, Giovanni Battista. Komentoi thjesht dhe fetarisht: „Në dhimbjen time e cila është edhe më e madhe shkaku i largësisë, më ngushëllon mendimi, si për të gjithë besimtarët, se do të gjendemi në qiell.“

Mons. Giuseppe Angelo Roncalli dëshiron të jetë vëlla e atë i të gjithëve, dhe për këtë përpiqet të



mësimin e gjuhës turke. Disa i thoshin se nuk i nevojitet, meqë bashkësia katolike lutet, kremton meshën dhe sakramentet në gjuhën frënge, me të cilën edhe shërbeheshin. Ai iu përgjigjet: „Po të isha unë turk, nuk do më tërhiqte feja e cila nuk e njeh gjuhën time.“ Dhe pikërisht për këtë e futi në liturgji edhe leximin e Ungjillit në gjuhën turke.

Edhe Greqia përjetonte vështirësi të mëdha në fusha të ndryshme. Mirëpo, njeriu i Zotit nuk dorëzohet askurrë, sepse në të gjitha rrethanat dhe kohërat jeton dhe dëshmon praninë dhe dashurinë e Zotit mes nesh. Mons. Roncalli në Greqi arrin vitin në vitin 1935. Së pari është dashur t'i tejkalojë dy mosbesime të mëdha: Qëndrimin e Kishës Orodokse Greke dhe mospajtueshmërinë e shtetit. Kushtet e jetës dhe punës për katolikët ishin shumë të rënda. Këtë gjendje menjëherë ia parashtrroi mbretit Georgios II, por me pak sukses. Me kënaqësi dhe shpesh e viziton Athinën, takonte hierarkinë katolike, bënte gjithë atë që kishte mundësi.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai është ambasador i vërtetë i paqes, pajtimit dhe faljes.

Diplomat i Hyjit

Pas luftës, ia edhe një sfidë e re. Në vitin 1945, Mons. Roncalli emërohet për nunc apostolik në Francë. Edhe një herë kjo ishte treguar si hap provanial, dha tani të gjithë do e quanin “Diplomat i Hyjit”. Gjatë dhjetë viteve ai përfiton të gjithë me zemrën e tij të madhe, me butësinë dhe thjeshtësinë që kishte.

Papa Piu XII i jep mirënjohje dhe e emëron kardinal vitin 1952. Mons. Roncalli është i hutuar, i befusuar, i prekur, dhe në ditarin e tij shkroi këto fjalë: *“Me të vërtetë krejt këtë e bëri Zoti, edhe atë pa mua, sepse nuk kisha mundur as të paramendoja, apo pretendoja për një mirënjohje kaq të madhe. Të jam i thjeshtë dhe përvuajtur nuk më ka krijuar problem të madh. Për çka të krenohem apo lavdërohem, O Zot imi? Merita ime është mirësia e jote...”*

Patriki Venedikut

Zoti tani më nuk po e le të qetë. Pas vdekjes së patrikut të Venedikut, Mons. Carlo Agostinit, Roncalli emërohet në vendin e tij në vitin 1953.

Në bazilikën e Shën Markut, i prezantohet besimtarëve spontanisht dhe me përvujtëri: *“Vij nga përvujtëria, isha i edukuar në varfërinë e lumtur dhe të bekuar e cila ka kërkesa aq të vogla... Provania më nxori nga fshati im i lindjes dhe bëri që të kaloj rrugëve të botës të Lindjes dhe të Perëndimit, duke u afriuar me njerëz të religjioneve dhe ideologjive të ndryshme, në ballafaqime me probleme të ashpra dhe kërcënuese të shoqërisë, mirëpo duke ruajtur qetësinë dhe baraspeshën e kërkimit dhe vlerësimit: gjithmonë kam qenë më tepër i zënë rreth asaj që na*

bashkon, se sa asaj që na ndan... Mirëpo, para se gjithash i porositem mirësisë suaj unë njeriu i cili thjesht dëshiron të jetë vëllai juaj i dashur, i afërt, i kuptueshëm ndaj të gjithëve...”

Mendoi dhe shpresoi se do e përfundonte këtë „shtegtim“ tokësor në Venedik. U përgatiste për vdekje sa më të mirë, por jo në mënyrë pasive. Vërtet ishte gjithkundvëlla dhe mik i të gjithëve, në veçanti i të varfërve dhe njerëzve të thjeshtë. Me kujdes dhe dashuri të madhe përcolli klerin e tij. Punoi, luti, meditoi, mendoi shumë, kurse me përpikëri natë e ditë shkroi ditarin e tij. Flinte pak, vetëm disa orë.

Mbi vdekjen shkroi këto fjalë: *„Mendimi mbi vdekje më bënë shoqëri të pikëllueshme, por edhe të mirë, që nga dita kur u emërova për kardinal dhe patrik të Venedikut. Për mua ky mendim është i vështirë, por edhe shpëtues. Mirëpo pjesa e jetës që më ka mbetur nuk është asgjë tjetër përpos përgatitje e lumtur për vdekje.“*

Kishte zemër të madhe, ishte mikpritës i mrekullueshëm. Shpeshherë iu thoshte bashkëpunëtorëve të tij: *“Kushdo mund të më vizitoj; ndoshta dëshiron të rrëfëhet? Unë jam një meshtar i varfër, dhe po e refuzova kënd, kisha mundur ta humbas një shpirt i cili ka dashur të hapët me mua.”*

Thjeshtësia dhe mirësia e tij së shpejti përfitoi të gjithë. Venediku i ishte sikur shtëpia e tij personale e lindjes Sotto il Monte, sepse ishte komunikativ dhe mik i të gjithëve.

Papa Gjoni XXXIII – Gjoni i Mirë

Në vitin 1958 vdes papa Piu XII, i cili, me vendosmëri e udhëhoqi Kishën e Hyjit për 19 vite. Kardinali Roncalli u pikëllua shumë shkaku i kësaj humbjeje të madhe, mirëpo e përjeton në heshtje, në mënyrë të krishterë, sipas motos së tij: në dëgjueshmëri dhenë heshtje!

Duke u nis për në Romë, në konklavë, tha: *“Gëzimi më i madh imi i cila do të mund të më ndodhë do ishte të kthehem pas disa javëve në mesin tuaj.”* Nxoribiletën kthyesë, në tavolinën e tij të punës la të hapur shumë letra të rëndësishme dhe të besueshme, duke shpresuar se do kthehej së shpejti.

Kisha, bota, po edhe kolegji i kardinajve pritnin shumë nga konklava. Flitej se do zgjidhej një papë kalimtar. Shpesh është përmend edhe emri i kard. Roncallit, i cili tani ishte në moshën 77 vjeçare, mirëpo kishte mjaftë përvojë diplomatike dhe pastorale. Në Bullgari dhe Greqi njohu ortodoksizmin dhe sllavët, në Turqi botën islame. Qysh më herët në Propaganda Fide ishte njohur me botën misionare; në Francë takoi civilizimin dhe kulturën europiane; në Venedik udhëhoqi suksesshëm një Kishë të vogël, por shumë të gjallë.

Nga Roma, kardinali Rocalli i shkruante ipeshkvit të Bergamos: *“Shpirti forcohet me besimin*



e Rrëshajave të reja të cilat do mund t'i jepte Kishës Shenjte ripërtwrrjen e tërësishme të Kreut dhe gjallërimin e gjymtyrëve. Nuk është me rëndësi se a është papa nga Bergamo. Lutjet e përbashkëta duhet të nxjerrin një njeri të shenjtë dhe të përkushtuar i cili me butësi dhe urtësi do të na drejtojë.”

Kardinali Angelo Giuseppe Roncalli është zgjedh papë me 28 tetor 1958. Pranoi këtë pas shumë mendimeve, pasigurisë, lutjeve, me këto fjalë: *“Atë që di me varfërinë dhe vogëlinë time mjafton për të më hutuar. Mirëpo, shoh në fytyrat shembullore të vëllezërve të mi kardinaj shenjtë e vullnetit të Zotit, pranoj zgjedhjen e tyre dhe uli kokën dhe krahët për barrën e kryqit dhe pirjen ekelkut të hidhët... Do të quhem Gjon. Ky emër është i ëmbël, sepse është emër i babait tim. Jemi të kënaqur, sepse është mbrojtësi i famullisë modeste ku jam pagëzuar..”*

Dhe menjëherë filluan brohoritjet e ngazëllimit, entuziazmit, lotët e gëzimit të Venedikut, të Bergamos, Sotto il Monte, Parisit..., gjithë atyre që e kishin njohur. Së shpejti e quajtën “Gjoni i Mirë”. Dhe i tillë, u tregua tërë jetën e tij duke i shërbye të gjithëve.

I befaso! të gjithë me shenjat dhe gjestet si dhe thjeshtësinë e sjelljeve të tija: Viziton spitalin Bambino Gesù në Romë, duke biseduar përzemërsisht dhe atësisht me fëmijët e sëmurë, me prindër, me personelin mjekësor. Më vonë vizitoi burgun Regina Coeli, ku mes të tjerave të burgosurve iu tha: *“Pra, ja Ne jemi këtu, bij të dashur... Erdha, më patë, ikam drejtuar sytë e mi në sy tuaj, kam vendosur zemrën time afër zemrës suaj...”*

Zemra e madhe – dashuria e papës Gjoni XXIII depërtoi edhe jashtë mureve të Vatikanit: 150 herë doli jashtë Vatikanit, duke ndërprerë kështu traditën e mëhershme shumëshekullore. Me shaka iu tha besimtarëve: *“Lejoni që të dalë edhe Papa nganjëherë, sepse Papa jeton i mbyllur në dy tre hapësira. Lejoni të vijë te ju, që t'ju ngushëllojë pak!”*

Koncili i dytë i Vatikanit

Mirëpo befasia më e madhe ishte paralajmërimi i Koncilit të Dytë të Vatikanit më 25 janar 1959. Në kuvendin e Shën Palit, afër bazilikës me emër të njëjtë, iu thakardinajve: *„Për t'i ballafaquar*



problemet e sotme të njerëzve, duke qenë të frymëzuar me traditë dhe të drejtë shumë shekullore, shpallim mbajtjen e Koncilit të Përgjithshëm Ekumenik...Synim i tij nuk është vetëm për ndërtimin e popullit të krishterë, por është një ftesëedhe për bashkësitë e ndara të ndara– në kërkim të bashkimit... Këtu gjithsesi do jetë edhe Shpirti Shenjt. Unë nuk frikohem. Ta fillojmë punën...”

„Vrapi“ i Papës nuk ndalet këtu. Në ekranet televizive me bindje dhe fuqi të thellë porosiste: *„Botës i nevojitet Krishti dhe Kisha duhet të jetë ajo e cila do t'ia sjellë botës Krishtin.”*

Më 4 tetor 1962 Papa me tren shtegton në Loreto dhe në Assisi, një javë para fillimit të Koncilit.

Koncili Dytë i Vatikanit ishte lëvizje e madhe shpirtërore dhe fetare, ngjarje shekullore, frymëzim i Shpirti Shenjt për Kishën dhe botën. Në hapje në Sheshin e Shën Pjetrit, ishin të gjithë, mbi 200.000 mijë besimtarë, 2400 ipeshkvij, argjipeshkvi, kardinalë, teologë, “vëllezërit e ndarë”. Gjoni i Mirë ka në zemër shumë dëshira, para së gjithave ta përditësojë Kishën – *aggiornamento*, të shërbente bashkimit etë të gjithë të krishterëve, paqes në botë.

Papa Gjoni XXIII, tha: *“nuk do të bëjmë ndonjë*



gjykim historik. Nuk do të hulumtojmë kush kishte të drejtë e kush kishte gabuar. Përgjegjësitë janë të shumta. Ne thjeshtë do të themi: të bashkohemi, t'i japin fund ndarjeve!"

Në kujdes për paqe ndërmjetëson dhe arrin sukses të shmangies së konfliktin mes SHBA dhe Bashkimit Sovjet rreth raketave ruse të vendosura në Kubë.

Sundimtarët botëror i porosiste: *"Bëni gjithçka është e mundur dhe në fuqinë e juaj për ruajtje të paqes: kështu bota do t'i shmanget tmerrit të luftës pasojat e së cilës askush nuk mund t'i parasheh... Të promovohen, përshpejtohen, të pranohen negociatat në të gjitha nivelet dhe në çdo kohë, ky është rregulli i urtisë dhe maturisë, e cila fiton bekimin qiellor dhe meriton kujdesin dhe mbështetjen njerëzore..."*

Dy enciklikat e Gjonit XXIII patën kuptim shumë të madh për Kishën dhe botën: *Mater et Magistra* (1961) dhe *Pacem in terris* (1963).

Ja disa vlerësimet të rëndësishme rreth tyre. John F. Kennedy: *"Si katolik jam krenar për ato, ndërsa si amerikan kam mësuar shumë nga prej tyre..."* U Thant, Sekretari i OKB-së gjatë një fjalimi tha kështu: *"Historia njeh shumë pak personalitete të cilët kanë pasur aq shumë nderim dhe aq dashuri sikur Papa Gjoni XXIII."* François Mauriac, nobelisti për letërsisë, dëshmon: *"Papa Gjoni XXIII ka thënë fjalë të mëshirës të cilat unë gjithnjë kam dëshiruar t'i dëgjoja prej Romës, dhe i ka thënë në praninë e vëllezërve të ndarë... Për herë të parë, pas rinisë time, Shpirti dëshmohej, së paku për mua në mënyrë të dukshme"*.

Gjoni XXIII jetoi dhe punoi për gjithë botën duke dëshiruar paqe, drejtësi, nderim mes njerëzve, dashuri, bashkim. Njëherë tha: *"Enciklika Pacem in terris është dhurata ime për Pashkë për mbarë njerëzimin. Puna me këtë nuk ka përfunduar. Deri më tani kemi përparuar mirë, mirëpo duhet guximshëm të vazhdohet ky rrugëtim."*

Vuaj me dhembje dhe me dashuri

Gjoni i Mirë tani më është në moshë të shtyrë, me punë të vazhdueshme dhe me plot përgjegjësi, takime zyrtare, kujdesi për mbarë Kishën dhe për gjithë botën. Ishte ky kryqi i përditshëm të cilin e bartte. Përpos këtyre halleve ishte e pranishme edhe sëmundja, mirëpo ai, si gjithnjë ishte i gëzuar, i qetë, optimist, pranonte vullnetin e Zotit. Mjekut i cili kujdesej për shëndetin e tij i tha: *"E di se fati im është sikur i Radinit... Valixhet i kam gatë për nisë."* Pas disa minutave të heshtjes dhe meditimit, vazhdoi: *"Nëse Hyji kërkon sakrificën jetësore të Papës, atëherë kjo le të shërbejë për hire të shumtatë Konkilit Ekumenik, të Kishës së Shenjtë, të njerëzimit i cili kërkon paqen."*

Sekretari personal Mons. Loris Capovilla, me lot

në sy, ia kumtoi se gjendjashëndetësore ishte keqësuar dhe se mjekët nuk mund të bënin më asgjë. Dhe qante. Gjoni i Mirë i tha: *"Shihe, shihe, Sekretari im, i cili duket aq i fortë, tani shqetësohet dhe qanë kur erdhi tek unë për t'më kumtuar gjënë më të bukur e cila mund t'i thuhet meshtarit: 'Sot do të shkosh në Parajsë...' E tash, ejani... Unë jam ipeshkëv, duhet të vdes sikur ipeshkëv, thjeshtë, por edhe dinjtetshëm..."*

Pas rrëfimit, vajimit të shenjtë dhe kungimit, në qetësinë më të madhe, në sigurinë e fesë, tha: *"Ja, duart e shtrira të Jezusit, ishin program i pontifikatit tim... Kërkoj falje nga të gjithë qysh nga rinia ime e deri me sot që kam pasur ndonjë mangësi Kam kërkuar, dëshiruar t'i dua të gjithë, iu kam dashur të gjithëve të mirën. Paraqes çdo vuajtje që të jenë të gjithë një: ut unum sint!... Vuaj me dhembje dhe me dashuri. Po e përcjell vdekjen time hap pas hapi. Tani me butësi drejtohem kah mbarimi... Mater mea, fiducia mea!"*

Vdiq në zë të shenjtërisëdheshenjtërisht më 3 korrik 1963, duke u lëshuar në duar të Zotit, në Siguri të Jetës, të Ringjalljes.

Gjoni XXIII ishte i mirë, i dashur, i përvuajtur, njeri i shpirtit dhe zemrës së madhe. Jetoi kohën e tij, mirëpoatë edhe e ka tejkaluar, me fe dhe dashuri, si profet. Pikërisht për atë jeta dhe veprat e tija mbesin të vlefshme dhe gjithmonë aktuale për Kishën Katolike, për kishat e krishtera, për çdo besimtar, për çdo njeri.

Shumë menduan se ai do të ishte një Papë kalimtar. Kurse ai, përkundrazi, ishte Papa i ndërrimeve, frymëzimeve, përtëritjeve, kthesave rrënjësore. Ai kishte zbatuar përditësimin për Kishën dhe në Kishë, kishte vizion profetik për ekumenizëm me botën e krishterë, dhe qëndrim të dialogut të hapur me të gjithë.

Për Kishën njëherë tha: *"Kisha katolike nuk është ndonjë muze arkeologjik. Ajo është burim i vjetër, i cili jep gjithnjë ujë e ri brezave të tanishëm, siç iu ka dhënë edhe atyre para nesh."*

Kurse duke bërë një përmbledhje të jetës së vet, kishte thënë kështu: *"Punuan, i shërbyem Kishës, nuk jemi ndalur duke mbledhur gurët të cilët na janë hedhur nga njëra apo ana tjetër... Dhe nuk kemi kthyer hedhjen e gurëve ndaj askujt... Një ditë Zoti, kur do të paraqitemi para tij, nuk do të na pyet a kemi bërë bashkimin, por do t'na pyet çka kemi bërë ne për bashkim... Kam nevojë për kryq. Jezusi Zot, më ndihmo ta barti me përvujtëri dhe dinjtet!"*

Papa Gjoni XXIII na ka zbuluar *"shenjat e kohës"*, kurse vet ishte dhe mbeti "shenjë" e kohës sonë, dhe më tepër "shenjë" e Zotit. Në nder të elterit është ngritur në 2000 vjetorin jubilar të krishterimit, kur Papa Gjon Pali II më 3 shtator e shpalli të Lumtur, ndërsa shpallet Shenjtë së bashku me të Lumin Gjon Pali II më 27 prill 2014.



NË KËTË TEMPULL HYJI VENDOS BANESËN E TIJ

Shugurimi i Kishës së të lumit Luigj Prendushi në Naraç- Dioqeza e Sapës



Dioqeza e Sapës dhe Bashkësia famullitare e Naraçit, në Vigjiljen e të Ngjiturit të Jezusit në Qiell, 17 maj 2023, gëzuan në festën e Shugurimit të Kishës së re kushtuar martirit i Lumi Luigj Prendushi. Të shumtë ishin besimtarët që morën pjesë në këtë ceremoni të shenjtë ku u bashkuan në lutje dhe i thuren lavde Zotit për shugurimin e këtij tempulli të ri.

Mesha e Shenjtë u udhëhoq nga Ipeshkvi i Sapës, Imzot Simon Kulli në bashkëkremtim me Nuncin Apostolik, Imzot Luigi Bonazzi, me Imzot Gjergj Meten dhe 30 meshtarëve të pranishëm, si dhe famullitari dom Emiljan Paloka. Në këtë kremtim ishin të pranishëm autoritetet civile vendore, bamirës të ndryshëm që kontribuan në ndërtimin e kishës si dhe miq të ardhur edhe nga Italia e Gjermania.

Menjëherë pas fillimit të Meshës, i zoti i shtëpisë, Imzot Simon Kulli me gëzim në zemër ju uroj mirëseardhjen të gjithëve duke shprehur mirënjohje të madhe kundrejt Hyjit, donatorëve dhe bashkëpunëtorëve tanë dashamirës, për të cilin gjendemi sot në këtë tempull ku Hyji vendos banesën e tij në mesin e këtij vendi dhe fton të gjithë besimtarët të vijnë në takim me Të, në kremtimin e mistereve të dashurisë së tij. Ndërsa vazhdoi me homelinë e rastit, “Imzot Simoni tha se ne jemi një popull dhe një familje të mbledhur rreth një tryeze, rreth tryezës së të njëjtit hir hyjnor, ndaj i përkasim edhe të së njëjtës shtëpi – shtëpisë së Zotit. Sot ne po shugurojmë shtëpinë tonë, Kishën që i kushtohet të Lumit dom Luigj Prendushit. Po,



sepse Kisha është shtëpia e të gjithë atyre që e duan Zotin dhe janë të dashur nga Ai. Brenda saj ndjehemi dhe jemi një bashkësi e mbledhur rreth një bariu për të jetuar të njëjtën jetë hiri. Është kjo kisha e parë e kushtuar martirit Dom Luigj Prenushi i cili ka domethënie të madhe. Duke vazhduar më tej, ipeshkvi tha se pak metra nga këtu, pikërisht në Shelqet, ditën e pushkatimit, përballë gjithë popullit tregonte gjyshja ime që ka qenë e pranishme, se Ai meshtar ishte i veçantë, sepse pasi e pushkatuan Ai qëndronte në këmbë nuk rrezohej në tokë dhe gjaku i tij shpërthente gjithkrah. Kjo do të thotë se toka nuk e donte, por e donte qielli - Lumnja e parrizit. Ky është martiri ynë që ka dhënë jetën për Krishtin dhe ne ia dedikojmë sot këtë tempull ku do të vijmë të lutemi e të marrim bekimet e Zotit – pohoi Imzot Simoni”.

Gjatë ritit solemn të Shugurimit të kishës së re, e cila ishte e mbushur me ndjenja gëzimi dhe lutjeje, Ipeshkvi bëri bekimin e mureve të tempullit të ri, që bekimi i Zotit të zbrësë mbi popullin e krishterë. Më pas vazhduan ritet e luterjes, kemimit, mbulimit dhe të shndritjes së elterit të cilat shprehin me shenja të dukshme disa aspekte të asaj vepre të padukshme që Zoti ushtron nëpërmjet Kishës, kur ajo kremton misteret hyjnore e në mënyrë të veçantë Eukaristinë.



Në përfundim të kësaj ceremonie, përshëndeti edhe Nunci Apostolik, i cili shprehi gëzimin e tij për këtë vepër të mrekullueshme të realizuar, por përcolli edhe përshëndetjen dhe lutjen e Atit të Shenjtë Papa Françeskut.

Sigurisht që në momentin e falenderimeve, nuk mungoi edhe fjala e Famullitarit, Dom Emiljan Paloka, i cili tha se famullia jonë por edhe Ipeshkvia e Sapes ishte dhe vazhdon të jetë e varfër në pikëpamjen ekonomike për të ndërtuar një objekt të tillë. Por së bashku me Ipeshkvin e Sapës, Imzot Simonin, kishim frymëzimin prej Zotit dhe martirëve tanë për të ndërmarre këtë nisem, ama kishim edhe vetëdijen që nga fillimi se, është vetë dora e Zotit që e ndërton shtëpinë e Tij dhe që sot bëhet Tempulli ynë i përbashkët. Ne thjeshtë ju dorëzuam provanisë dhe zemërgjerësisë së Zotit, vetëm lejuam që duart tona ti shtrijmë dhe ti bashkojmë me duart e Tij dhe të qindra mijëra bamirësve, duke ju besuar shikimit dashamirës nga qielli të Martirit dhe paraardhësit tonë dom Luigj Prendushit.

Violeta Marashi

STATUTET E SHKODRËS TË RRETH 700 VITEVE MË PARË !

Ne heshtim, kur kemi një dëshmi 700 vjeçare të rregullimit juridik të shoqërisë, me të cilën çdo shtet do ta ndiente vetën shumë krenar sot !

Më 23 qershor 2023, në ambientet e rektoratit të Universitetit të Shkodrës, organizuar nga Departamenti i Historisë dhe shoqata *Korabi ABS*, me seli në Itali, u mbajt promovimi i librit të ribotuar *Statutet e Shkodrës* e financuar me këtë rast nga shoqata e emigrantëve shqiptare dhe Arbëreshe të Italisë, *Korabi*.

Ribotimi i tyre i përditësuar, u promovua sot në Shkodër, pas botimit të më shumë se 10 viteve më parë. Statutet e Shkodrës, u zbuluan në vitin 1997 në bibliotekën e Venedikut nga studiuesja e famshme italiane, Lucia Nadin, dhe u përkthyen në shqip nga historiani i mirënjohur, Pëllumb Xhufi. Ky botim është Kushtetuta e Shkodrës nga gjysma e parë e shek. XIV, me shtesa deri me 1469, e shkruar germë për germë dhe jo e treguar, u theksua nga studiuesi e mirënjohur, akademiku Pllumb Xhufi. Një dëshmi të tillë juridike 700 vjeçare, çdo shtet do ta shfrytëzonte për t'u treguar të tjerëve rregullimin juridik të popullit të vet, në prag të mësymjes pushtuese osmane, u shpreh nder të tjera, autorja e veprës, albanologia, Lucia Nadin. Ndërsa ne, që fatkeqësisht edhe sot ka qarqe armiqësore që na akuzojnë si mosdashjes të shtetit dhe të paaftë për të ndërtuar shtetin, heshtim



dhe nuk u kundërvihemi me dëshmi të tilla duke u kujtuar që në mesjetë së Shkodra e Arbërisë, kishte statute juridike, për rregullimin e veprimtarisë së tyre, do shprehej, kryetari i shoqatës *Korabi*. Takim përfundoi duke shpërndarë falas të gjithëve të pranishëm nga një libër, i shtypur me një cilësi shumë të lart, siç e meriton dhe tematika në fjalë.





VITRINË LIBRI

Gjovalin Gjeloši

FRATI I HOTIT
PADËR KOLË P. BERISHAJ

Botimet Fishta, Lezhë



STATUTET E SHKODRËS

Botime IDK



Anisa Kosteri

LEKSIKU I PASUR NË
FJALORIN E BASHKIMIT

Shtëpia Botuese: Shkodra

KUMBONA E SË DIEËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIEËS

Viti XXXVI, nr. 5/6 (567-568) Maj - Qershor 2023